

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-7

K89

GAZMEND
KONGOLI



**Fus
Flu** tani
tunues

TREGIME
DHE SKICA
HUMORISTIKE

SH-2
K 89.

GAZMEND KONGOLI

MUHAMEDI BREDH ME DËSKA

FUSTANI FLUTURUES

tregime dhe skica humoristike



20298

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

MUHAMEDI BREDH ME DERRA

Disa gojë të liga nisën të flisnin keq për tufën e re të derrave që ishte munduar të krijonte kooperativa, për Muhamedin, edhe për kërrabën e tij. Muhamedi s'i ndahej kërrabës. Ai i ngjante kërrabës dhe kërraba atij. Kur sokëllinte Muhamedi, sokëllinte edhe kërraba. Dhe tufa e derrave i bindej njësoj, si Muhamedit edhe kërrabës. Po gojë të liga nuk bindeshin.

— Edhe Muhamed, edhe me derra! Kjo s'durohet!

— Këta derra të shëmtuar po na trembnin kalamajtë.

— Ajo kërrabë i duhet kthyer atij e t'ia bësh kurrizin më të butë se barkun!

Thashethemet lëkundën edhe kryetarin. Që te mbyllte gojë të liga, ai i tha Muhamedit:

— Ç'dreqin e ke edhe ti këtë emër, o Muhamad?! Sikur ta ndryshoje...

— Punë që s'bëhet — tha Muhamedi — Ç'ka bota me emrin tim?

— E po mirë, të paktën m'i vrit këta dy më të shëmtuarit e m'i gropos dy metra thellë, se nuk shikohen me sy.

— Punë që s'bëhet — tha Muhamedi. — Ky

është kryetari i derrave tanë, ky tjetri është zëvendësi. Ç'kanë bota me turinjtë e tyre, sikur do të bëjnë krushqi me ta!?

Kryetari mbeti keq midis gojëve të liga e gojëve të mira. Dha e mori në kryesi dhe gjeti rrugën e mesme. U vendos t'u jepej 7 kilometra rrugë derrave tutje në fshatin tjetër të kooperativës, që ishte si mënjane. Atje i vendosën në një zabel si të fshehur nga sytë e nga gojë.

Të nesërmen plasi një gurgule në fshat. Ata që s'kishin mbyllur sy gjithë natën nga kjo ekspeditë e jashtëzakonshme, nuk mbyllën gojë edhe tërë ditën.

— Ç'domethënë kjo? Për klimë i prunë derrat këtu?

— Jo, s'kemi nge të na hanë derrat fëmijët!

Muhamedi me kërrabë në qafë përgjegjëj shtruar:

— Ndreçni gojën, ore! Nuk hanë derrat fëmijët, po fëmijët do të hanë derra e do të bëhen buçko.

— Do të marrim hijen e derrave — ankohej **ndonjë.**

Por Muhamedi, që kishte mësuar nga veterineri i kooperativës shumë gjëra për derrat, shpjegonte:

— E keni gabim. Nga studimet e fundit del se derri është nga kafshët më inteligjente.

— O po na qelbën dynjanë këta derra! — ngulte këmbë ndonjë tjetër.

— Gabim! — kundërshtonte Muhamedi — Hajdeni e shikoni me sytë tuaj. Derri, në çdo stallë që ta vendosësh, cakton vetë një cep të veçantë për... Kurse lopa jo. Derri është më i kulturuari, o vëllëzër.

Mirëpo kush e dëgjonte Muhamedin!

— Ç'është ky dreq Muhamed kështu, që mban leksione për derrat!? S'ka turp të turpërohet e t'i nxihet faqja!

Me njerëzit sikur s'po u shkonte gojëve të liga, por derrat ama i vunë përpara e i shpërngulën, me gjithë Muhamed e me gjithë kërrabë.

Muhamedi me derrat përpara e la vrapin në fshatin më të largët të kooperativës. U shtynë edhe 5 kilometra të tjerë derrat brenda muajit. U bënë telef. U ligën e u shëmtuan më shumë. Iu rrit qimja e u dolën brinjët. Njëri theu këmbën rrugës dhe Muhamedi i lidhi një copë hu si patericë.

Kur e panë në fshatin më të largët tufën e derrave, disa nisën të gajaseshin.

— Ç'është ky derr me patericë?

Muhamedit i kishte ardhur në majë të hundës.

— Atë e dua më fort nga të gjithë dhe më vjen keq ta ther e ta ha njëherësh. Prandaj i këpus nga një copë e nga një copë. Fillova me njerën këmbë — thoshte ai.

Më së fundi derrat u vendosën në një stallë të vjetër rrëzë kodrës. U caktuan edhe 7-8 hektarë tokë për t'u mbjellë me jonxhë, tërfil e panxhar. Por një ditë derrat u gdhinë të rrethuar.

S'u kishin lënë asnjë pëllëmbë tokë. Deri në rrëzë të stallës tokat u mbollën me lloj-lloj kulturash, vetëm me nga ato që hanë derrat, jo.

— Shiko, se bëjnë këmbë derrat jashtë e na pri-shin të mbjellat, pa ti di! — e kërcënuan Muhamedin.

Muhamedi me vrap shkoi në kryesi.

— Derrat! Janë izoluar derrat!

— E po mjaft, de! Na hëngre shpirtin me derrat!
Oj, derrat sot, derrat mot, si s'mori fund ky avazi i
derrave?! — u nxeh dikush nga ata të kryesisë.

Më në fund u vendos të hapej një rrugicë nga
dera e stallës që të hynin e të dilnin derrat njëshkolonë
tutje buzë përroit. Bëri ç'bëri Muhamedi e i disiplinoi
derrat. Po do ti, një ditë zëvendësi i kryetarit të tufës
nuk duroi më atje buzë përroit dhe mori yrysh e shkoi
u fut në një blok mandarinash. Më t'iu vunë prapa qen,
kalamaj e rojtarë e sill me gur e bërtit e shaj, sa atij
iu thyen këmbë e brinjë. E pa Muhamedi që zëvendësi
po rrotullonte sytë nga dielli dhe i futi thikën. I erdhi
keq sa s'bëhet më, por i erdhi edhe një çikë mirë. Dy
vjet kishte kooperativa me tufë derrash, po asnjera nga
mensat s'ua kishte ndjerë jo lezetin, por as erën!

Mirë zëvendësit, por as kryetarit e as të tjerëve
s'po u ecte mbarë. S'u zinte më dhëmbi as mbeturinat
e misrit. Dy prej tyre ua lanë shëndenë të tjerëve. Erdhi
zooveterineri t'u bënte autopsinë. I kërkoi njërit një thikë.

— Nuk kam.

— Po bukën në shtëpi, me se e pret?

— E thyej me duar.

— Po shalqinin?

— E çaj në gur.

Zooveterineri mori e i çau derrat me një drapër.
Mbasi mbaroi punë, lau duart me sapun dhe ia ktheu të zotit.

— Hidhe se s'më hyn në punë! — tha ai i sapunit.

Muhamedi tha:

— Thonë kot «inat derri»!

S'ishte e thënë t'u ecte mbarë as Muhamedit, as derrave, as kërrabës së tij.

— Më mirë ta dorëzoj kërrabën, o shoku zooveteriner.

— Mos u dorëzo, Muhamed.

— S'dorëzohem unë, por po dorëzohen derrat — tha Muhamedi.

Kështu erdhi një ditë që se kush u ngrit me vullnet «të mirë» dhe deshi të zbatonte fjalët: «Nëse lopa është fabrikë qumshti, derri është fabrikë mishi.»

— O burra — tha — që të plotësojmë planin e mishit!

Pa një, pa dy i hipën derrat në karrocerinë e maqinës. Nga shpejtësia se mos vinte ndonjë urdhër dhe e prapësonte këtë punë të paqme, mbreti i derrave ra në përrua në një gropë të thellë me ujë e me llucë. Si t'ia bëjmë e ku t'ia bëjmë?

— Ta rimorkiojmë!

Nxorën kavon.

— Nga ta lidhim? Për qafe mbytet, për këmbe i shqyhet kofsha...

— Për mesi!

— Hajt për mesi!

E lidhën për mesi. E tërhoqën. Gërhitjet e mbretit llahtarisen dynjanë. Por më në fund mbreti u përplas në karroceri. Kësaj radhe derrat me mbretin e tyre të lerosur e të katranosur shpëtuan nga marshimet kalitëse. U ndanë të mallëngjyer, me lot e përqafime nga Muhamedi i tyre i dashur. Dhe të krekosur, por të heshtur, i përshkuan kilometrat me maqinë. Më së fundi peripecive po u vihej kapak me një udhëtim të këndshëm. Por s'ishte e thënë që t'i jepnin fund jetës me këtë gëzim në zemër. Kur arri-

tën në grumbullim, shoqëruesit vunë re se ishte zhdukur mbreti.

— E nga u tret ai derro mbret i shëmtuar?

Mbasi zbriti tufa, mbreti u gjend midis karroce-
risë me këmbë nga dielli.

S'dihet nga e pat, e nga e gjeti. Nga malli për Muhamedin e kërrabën, nga havaja, apo nga përbuz-
ja e njerëzve, pse ishte aq i shëmtuar? Shkurt, plasi
prej së keqes.

Por e keqja nganjëherë ka edhe të mirën pas.
Mbarimi i derrave, ngjalli shqetësime në kooperati-
vë.

— Cili qe ai qesharak që dha këtë urdhër qesha-
rak?

— Cilat janë ato gojë të liga që u hapën çorap
dhe telëndisën rrugë pa rrugë Muhamedin me gjithë
derra?

— Kush ia vuri këtë njëllë kooperativës sonë?

...Dhe sot e kësaj dite vazhdojnë kritika e auto-
kritika në kooperativën e Muhamedit. Duket s'i është
mbushur qypi ende ndonjërit prej atyre që s'duan
s'i shohin me sy derrat. Por ama Muhamedit i është
bërë qejfi pishë. Me kërrabën në sup ai sokëllin sa
majtas e djathtas krenar për tufën e re të derrave,
që e krijoi përsëri dhe po e shton e shumon për shta-
të palë qejfe!

...Dhe sot e kësaj dite vazhdojnë kritika e auto-
kritika në kooperativën e Muhamedit. Duket s'i është
mbushur qypi ende ndonjërit prej atyre që s'duan
s'i shohin me sy derrat. Por ama Muhamedit i është
bërë qejfi pishë. Me kërrabën në sup ai sokëllin sa
majtas e djathtas krenar për tufën e re të derrave,
që e krijoi përsëri dhe po e shton e shumon për shta-
të palë qejfe!

VËLLEZËRIT ZYLALË

Me të shkelur në prak të vatrës së kulturës, një-
rëzit m'u mbloodhën grumbull:

— Shoku fotograf, unë desha të bëja një pozë
me të fejuarën...

— Po nuk përtove, ja, këtu afër e kam shtëpinë
unë, të na nxjerrësh familjarisht...

— Ne jemi grupi artistik i fshatit. Shkrepe një
herë këtu përpara vatrës së kulturës! Mblidhuni ju,
ore!

— Po fotografi për diploma bën ti, shoko?

Mezi ua preva vrullin:

— Vëllezër, nuk bëj fotografi unë. Kam ardhur
për një ekspozitë. Ku është përgjegjësi i vatrës, ju
lutem?!

— Si, ore, për ekspozitë?

— Përton ti, o vëlla, apo si? Me para në dorë të
themi.

— Po aparatën në qafë pse e ke ti?

U mundova edhe një herë t'i sqaroja:

— Unë nxjerr fotografi vetëm për ekspozitë.

— Shiko, shiko! Domethënë këta surretërit tanë
s'qenkan për ekspozitë!

— S'ia mbushim syrin ne!

— E si duhet të jenë ata për ekspozitë, shoko?
Njëri, si duket nga ata të grupit artistik, tha me seriozitet:

— O po këreni rehat tjetrin, se e hutuat! Për ekspozitë kërkon ti, vëlla?

Grumbulli i njerëzve ia plasi gazit. Ai i grupit artistik duhej të ishte nga ata që nuk u shkon për shtat serioziteti.

Unë nuk njihja asnjëri. Për herë të parë shkelja në atë fshat.

— Po — i thashë.

— Mbaj shënim — tha ai.

Të tjerët përsëri qeshën.

— Asllan Zylalin, ose, po s'ta mbushi syrin ai, të vëllanë, Kapllan Zylalin.

Sa herë fliste ky, të tjerët qeshnin. Nisa të dyshoja dhe e pyeta:

— Kush je ti e cilët janë këta Asllanër e Kapllanër?

— Unë jam këtu në vatër — tha ai — kurse Asllani e Kapllani, domethënë dy vëllezërit Zylalë janë tamam për ekspozitë, ashtu siç i kërkon ti.

— O po ku punojnë, të shkretën?! — thashë unë i mërzhitur, se më dukej sikur po rrihja kot ujë në havan.

— Asllani është artist, Kapllani është dhaskal.

— Do t'ju lutesha t'i kërkonit — thashë unë.

Të gjithë kalamajtë aty rreth e rrotull fluturuan nga të katër anët si harabela, për të thirrur vëllezërit Zylalë.

Pas pak në sallën e vatrës së kulturës hyri artisti me një tufë harabelash nga pas.

— Asllan Zylali! — u prezantua ai.

Tepelekun e kokës e kishte mbuluar me postiqen e gjyshes. Lëshova sytë poshtë, për ta parë si thotë populli, nga kreu te këmbët. Më vajtën sytë te pantallonat e gjera ala kauboj dhe te rripi i trashë që i mbërthente mesin. Në mes të rripit kishte një palldëm gomarësh, ku «artisti» mbështeste në një pozë «artistike» të dyja duart. Ngrita kokën ta vesh-troja në sy e ta përshëndesja. Poza e duarve të mbështetura në palldëmin e mesit kombinonte me pozën e syve.

— Ç'kemi? — i thashë.

— Ja, këto që kam veshur — u zgërdhi ai.

— E, shoku fotograf, të pëlqen për ekspozitë? — tha dikush.

— Kopje e rrallë — thashë unë.

Ndërkaq ia behu në sallë dhaskali me një tufë tjetër harabelash.

— Kapllan Zylali! — u prezantua.

Dhaskal e shkuar dhaskejve, për besë! Mjekra i varej dy pëllëmbë. Një palë pandofla të grisura i hiqte zvarrë.

Khaketa i ishte ngrënë vende-vende.

— Ç'kemi? — i thashë.

— Ja, këto dy pare mend në kokë, asgjë tjetër — foli rëndë-rëndë.

— E, shoku fotograf, po ky tjetri, të pëlqen ndopak për ekspozitë?

— Ç'është ajo ekspozitë? — pyeti dhaskali.

— Ekspozitë e kopjeve të rralla — thashë unë.

— Pa merrni të dy një pozë pranë njëri-tjetrit!

Unë bëra gati aparatën, kur në atë çast hyri përgjegjësi i vatrës së kulturës.

— Një sekondë, shoku fotograf! Dale t'i nxjerrësh të tre vëllezërit bashkë!

Midis dy Zylalëve ai vuri një dordolec, që posa e kishte shkukur nga ara.

DULJA, KIÇUA DHE LIKUA NË DARE

Të tria kokat rrumbullake u afruan hundë me hundë.

— Pisk e kemi!

— Ç'thoni, a do të mund të hedhim vanë?

— Si gjithmonë, ore!

— Si gjithmonë, por s'më duket të jetë si gjithmonë kësaj radhe.

Dulja tha:

— Kot shqetësoheni. S'është e para herë që do ta vërtisim...

— Kurse unë — tha Likua, duke mbajtur llapën e veshit me dorë, se ishte pak i rëndë në dëgjim — unë do të thërras në ndihmë sinqeritetin.

Dy të tjerët hapën sytë.

Dhe të tre ngjiten shkallët. Zunë një cep nga fundi i sallës. Secili bluante në kokë të vet. Përsëndetjeve të shokëve u përgjegjeshin me nga një buzëqeshje të ftohtë. Salla gumëzhinte nga bisadat me zë të ulët. Pastaj u bë heshtje e madhe. Në tryezën në krye të sallës zunë vend tre vetë. Mbledhja filloi. U mbajt një raport i shkurtër. Megjithëse e dinin, atyre të treve — Dules, Kiços dhe Likos me do-

rën në llapë të veshit — u ndryshoi ngjyra e fytyrës, kur iu përmendën emrat në raport për keq.

— Ka pyetje?

S'kishte asnjë.

— Atëhere fjalën e keni ju — tha ai që drejtonte.

Filluan diskutimet.

Dulja, Kiçua, Likua në cep nga fundi as që morën vesh se ç'thanë ata dy të parët që u ngritën e diskutuan. Diçka bluanin.

— Me lejë! — mori guximin Dulja.

Ai nisi të recitonte kodin agroteknik që e kishte mësuar qëkuri përmendësh si kryetar kooperative bujqësore që ishte. Veçse shtonte një e më dy nga xhepat e tij nga një «duhet». Por dikush nga ata që dëgjonin (as Dulja vetë s'e mori vesh se kush) ia preu:

— Shoku Dule, kërkojmë të dimë, pse jeni keq me pambukun?

Disa menduan se Dules do t'i ngecte pështyma në fyt, por jo. Ai tani ishte në vrull e sipër. Me të dënuar shkaqet negative, do t'u futej me dru koncepteve të vjetra dhe menjëherë do të parashtronte zotimet si ngahera. Për ta vërtitur, atij s'ia hante qeni shkopin. E tha:

— Po ju e dini! Vitin e parë e pati fajin fara, të dytin krimbi, të tretin klima dhe sivjet shirat.

— Po vitin që vjen? — pyeti dikush.

— Vitin që vjen? — tha Dulja, që s'e priste këtë pyetje. — Vitin që vjen me siguri do të shpifet ndonjë gjë tjetër, që të na bëjë të ngremë përsëri duart përpjetë ndaj atij të flamosuri pambuk!

Se përse qeshën të gjithë, Dulja s'mori vesh gjë,

mbasi po matej të zhvishte pallën për të sulmuar konceptet frenuese. Por se kush kërceu përpjetë atje në ballë.

— I kemi dëgjuar katër vjet rresht këto justifikime, shoku Dule. E vërteta është ajo, që s'do të na e thuash ti këtu. Keni rënë në ekonomizëm të trashë, shoku Dule. Ju ka mbytur leverdia dritëshkurtër.

Tjetri vazhdoi edhe ca dhe Dulja s'dinte ç'të bënte, të ulej apo të rrinte më këmbë. Dikush e terhoqi nga xhaketa, që të ulej se ishte ngritur një tjetër për të diskutuar.



Likua, me llapën e veshit të përkulur si para-
fango, buzëqeshi nën mustaqe. «Ehë, s'pinë ujë më
metodat e vjetëruara, o Dule vëllai. Të thashë, du-
het thirrur në ndihmë sinqeriteti!» — thoshte me
vete i krekosur. Dhe s'po e mbante karrigia sa të ço-
hej e të merrte fjalën.

Kur u ngrit, ngjeu fytyrën me ngjyrën e për-
shtatshmë për këto situata dhe, kokëvarur, duke loj-
tur pjesën e të ndjerit thellë të gabimit, filloi me zë
të dredhur:

— Ta them troç e sinqerisht, ore shokë, ne i ke-
mi kthyer krahët pambukut. Flas për kooperativën
tonë...

Dikush psherëtiu në sallë: «Këtij i them disku-
tim unë!»

— Shokë! Jeta i ka hedhur poshtë të gjitha justi-
fikimet. E vërteta është vetëm një: Ne kemi shkëlur
kushtet themelore të fondit agroteknik.

Heshtje e plotë.

Likua e shtoi vrullin.

— Në radhë të parë nuk kemi treguar kujdesin e
duhur në caktimin e tokave të pambukut. Së dyti,
pambukut nuk i kemi plötësuar as minimumin e kër-
kesave. Besomëni, asnjë kilogram pleh organik nuk
i dhamë pambukut! Vija kulluese jo, drenazhim jo...
E sa për atë ekonomizmin e trashë, unë jua them sin-
qerisht, që s'e kam njohur ndonjëherë as të trashin,
as të hollin...

— E katranose me këtë të fundit — i pëshpëriti
ngadalë Kiçua aty në krah.

Likua as që e dëgjoji pëshpëritjen e Kiços. Ai po
merrte yrysh e rrezik të mos përmbahej më, por për
dreq e ndërpreu pyetja:

— Për tri vitet e kaluara flet kështu ti, Liko?

- Për ato e për sivjet.
- Ç'domethënë edhe për sivjet?
- Edhe për sivjet domethënë edhe për sivjet.
- Po ç'të mbajti ty t'i bëje të gjitha këto që na

numërove këtu?

Likua u hutua.

Pa marrë frymë mirë fluturoi pyetja tjetër:

— Po pse s'e prashite e pse s'e ujite pambukun tani, apo i le edhe këto për autokritikë?

Megjithëse e dëgjoi fare mirë, Likua u përkul më fort me llapën e veshit përpara e tha:

— Urdhëroni?!

Ia përsëritën prapë. Likua shtrydhte trutë te gjente shpejt e shpejt një përgjegje të sinqertë. I zënë mat, ngriti pëllëmbën e dorës e tha:

— E mori dreqi dhe këtë punë!

— Çfarë?! — u çudit njëri në presidium.

— Singëritetin! — tha Likua padashur.

Salla shpërtheu në të qeshura.

— Po barërat e këqia pse i le ta mbysin pambukun?

Likua përpëlitej. S'dinte ç'taktikë të përdorte më.

— Bëre ç'bëre, e le për faqe të zezë, po tani a e fillove krasitjen?

Likos i shpëtoi nga goja:

— Posi, posi! Krasitje thatë? për mua thatë? Posi, posi!

Kiçua, që një çehre i vinte një i shkonte, u bë sa një grusht aty midis Dules dhe Likos. Ai tanimë kishte hequr dorë nga të gjitha taktikat dhe vendosi: «Sikur vinçat të më sjellin, nuk ngrihem të flas. Më mirë t'i ha dajakët kështu ndenjur...»




JASTËKU

Ata të seksionit më hoqën nga puna për paaftësi. Të kishte qenë për shefin, s'tundeshë që andej unë as për 25 vjet e as kurrë. Por ç't'u bësh çapaçulëve të tjerë, që na vunë përpara si mua si shefin për punën time. Dha e mori shefi i varfër, s'la gur pa luajtur, që të më mbante pranë, por s'i eci. Dhe, kur i ngeci keq, ngriti duart përpjetë e u dorëzua. Më donte kiamet, se kishim muhabet të lezetshëm bashkë.

Aq sa i mori ujë lopata, e bëri të vetën shefi deri në fund. Vendi ku do të shkoja, vërtet ishte vrima e fundit e kavallit në sektorin e gjerë të seksionit, ku në krye ishte shefi im i dashur, por megjithatë atje do të quhesha drejtues, me një vartës e gjysmë. Gjysma ishte pastruesja që do ta kishim të përbashkët me një qendër pune tjetër. Me fjalë të pakta, heqja ime nga seksioni doli si punë gradimi.

Në takimin e ndarjes me shokët e seksionit, shefi e mbylli fjalën e tij kështu:

«Shokun Laze po e çojmë atje si dorë të fortë.»
Shoku Laze ishë unë dhe unë e dija se s'ishë hiç dorë e fortë. Madje pasdite në kafene, kur e qerasa dhe e falënderova për dashurinë e pakufishme që ushqente ndaj meje, ia thashë në konfidencë, se si zor ta



© 1950 by [illegible]

qullosja edhe atje ku po më çonte. Mirëpo xhanani po xhanan ngelet. Më rrahu krahët e më tha:

— Hë, se e bën ti, e bën! Madje kam besim se ke për ta qarë fare!

— He, ti rrofsh, o shoku shef! Edhe vetëm gajreti që më jep, s'ka të blerë e të paguar — i thashë.

Pastaj ai më tha:

— Këtë ta kemi shënuar edhe në motivacion.

— Çfarë — pyeta unë — që kam për ta qarë?

— Që je dorë e fortë — tha shefi.

Kështu, nga vartës kalova në drejtues. Më dërgoi vetë shefi ditën e parë në zyrën e re, më prezantoi me vartësin e gjysmën e shërbyeses dhe në shenjë kujtimi më dhuroi një jastëk për karrigen e zyrës së re.

Si dorë e fortë, vërtet nisa ta qaja. Duke përgjuar pa dashje, një ditë dëgjova gjysmën e pastrueses tek shtrembëronte fytyrën e i pëshpëriste vartësit tim:

— Derëziu ti! Përse ta prunë këtë, për kokosh? Ai hyn e del e tund zinxhirin, ti gdhin mbi punë...

Shtrengova dhëmbët e thashë me vete:

«S'ta mbushkam synë, ë? Dale të më shohësh mirë e të më njohësh.»

Për t'ia gjetur anën një gjysmëshërbyeseje nuk është dhe aq vështirë. Pastaj shefi e kishte thënë me gojën e vet, se më kishin dërguar këtu për dorë të fortë. Brramp grushtin unë, dhe gjysmëpastruesja fluturoi nga sytë këmbët.

Pas ca kohe, vura re se fytyra e vartësit sikur po vinte dita-ditës duke u shtrembëruar gjithnjë e më keq.

«A, thashë me vete, fytyrështrembërit s'pinë ujë

këtu, djalë i mbarë. I zoti boll, je, por ç'më duhet zotësia tënde, kur s'ke fytyrë të ëmbël për mua!»

Vendosa t'ia nisja punës njëherazi në dy drejtime paralele: Të kërkoja njeri tjetër e t'ia gjeja anën këtij vartësit tim.

Para së gjithash më shkoi mendja te një kushëriri im nallban. Edhe vetë do të bija rehat, se kushëriri më ngjante krejt mua në fytyrë edhe atë do ta shpëtoja nga zanati i rëndë i nallbanit. Mirë po ç'e do! S'më ndezi. Dhe nga se, do thoni ju? As që jua pret mendja fare. S'deshi nallbani, im kushëri! E pse? Të shkrihesh gazit!

— Le që s'e bëj dot — më tha — por zanati i nallbanit vetëm namini e ka të rëndë e të përçmuar. Është zanat me pasion. S'lihet ashtu kollaj, si thua ti.

— Të rruat, more xhan! — i thashë.

Ç'ta zgjasja me tuafin. Aty vura re që kishte ndërruar fytyrë e s'më ngjante fare mua. U vura përsëri në kërkim. Çava dheun për një njeri që ta kishte fytyrën si timen. U bëra telef. Mirë thonë që s'i gjen dy njerëz njëllor në këtë botë. Por të paktën të më ngjante sadopak. Ky që kisha po m'i gërryente zorrët përbrenda. S'e duroja dot më. Anën ia kisha gjetur për ta surdisur. «I shet mend përgjegjësi, dmth mua, sikur di më shumë e sikur është vetëm ai i zoti.» Me këtë e mbërtheja ijë më ijë. Sepse edhe sikur ta kundërshtonte atë shitjen e mendjes, për të cilën mua më mungonin faktet e provat, e zija mat me punën e zotësisë. Aty s'kishte nga të bënte bisht, se faktet e provat flisnin copë.

Dhe dita e bardhë zbardhi. Më erdhi zogu drejt e në dorë. Një mesoburrë, afër moshës së pensionit, që nga këmbët e në majë të kokës s'më linte gjë

mangut mua, erdhi e u ul përballë tryezës sime në zyrë. Kishte me vetë rekomandimin e baxhanakut tim. Që nga mënyra e parashtrimit të qëllimit anës e anës, që bëri në hyrje të muhabetit, m'i hapi për bukuri fletët e zemrës:

— Gjithë jetën kam qenë kokulur e i bindur, qejfaprishur e punëpabitusur. Përgjegjësi përgjegjës e vartësi vartës, secili ka vendin e vet, secili ka rrogën e vet. S'e përmbyska e s'e bëka çorap përgjegjësi? Vartësi duhet të rrokulliset aty ku e përmbys përgjegjësi dhe mundësisht të bëhet shtizë për të endur çorapin përgjegjësi. Fundi i muhabetit, unë e kam hallin sa të ha rehat një copë bukë, se më kanë vënë syrin për qarkullim. S'e kam aq te qarkullimi, se sa te pensioni që më ulet. Pastaj edhe turp më vjen kur të thonë bota: «E hoqën se nuk qe i zoti i punës». Ja, pse do të dëshiroja të vinit dorën në zemër e të më...

E ndërpreva me lot nër sy. Më preku aq fort, sa u çova dhe e përqafova me mall.

— Haj, haj ta shikosh me sytë e tu zyrën tënde të ardhshme — i thashë.

Dhe e çova në zyrën ku do të punonte si vartësi im. Ai tjetri as që e ngriti kokën nga puna. U kthyem në zyrën time.

— E? — e pyeta.

— Mrekulli — tha — vend pëllumbash! Veçse asaj karriges do t'i bëj një jastëk.

— Hiç mos u mundo! Ditën e emërimit kam qejf të ta dhuroj unë një jastëk. E kam kujtim nga shefi.

Më e paqmja punë mos qoftë zyra me një vartës që s'ta prish kurrë, s'di se ç'mund të jetë tjetër;

më e rehatshmja punë mos qoftë ajo kur ke mbi kokë një shef të dashur e me muhabet të lezetshëm, s'di ç'mund të jetë tjetër; më e ëmbla punë mos qoftë karrigja me jastëk të butë, s'di ç'mund të jetë tjetër.

Mirëpo ja që s'janë të gjithë njerëzit me një mendje. U ngrit një tufan e një furtunë në seksion e se ç'u shkrepiti të na prishin punën tonë të paqme, të rehatshme e të ëmbël, të ujditur me aq merak. Shefit i kërkuan llogari sepse më kishte zgjedhur mua sipas fytyrës së tij. Mua ma bënë tetë me dy se pse kisha zgjedhur vartësin sipas fytyrës sime, dhe...

Çfarë t'ju them më tej? Vartësi im fluturoi nga njëra anë, unë fluturova nga tjetra, shefin e zbritën në vendin tim. Kiameti s'u bë xhanëm, se të gjithë zumë vendet që meritonim, por ç'e do që ngelëm pa jastëk...

begenisnin të merrnin as bukën në dyqan, pa le të conin e të merrnin fëmijët në çerdhe e kopësht! Preu edhe kokat e atyre që përqeshnin të tjerët si burra grash me hundë të zgjatura pas fustaneve. Preu edhe kokat e atyre djemve, që e mbanin veten për agallarë të motrave.

Dhe masa tha:

— Hë, më i lumtë krahu!

Se nga ishte shtruar një darkë këmbëkryq Kili Rrumbullaci, dhe e shoqja, e të zotit të shtëpisë, mikut të Kilit, nuk ishte ulur për të ngrënë bashkë me ta. Kili Rrumbullaci të nesërmen s'e bëri hiç të gjatë, po i vari mikut një alamet fletërrufeje, sa la pa mend me kuç e me maç.

— Para emancipimit Kili s'vë as nënë as babë — tha masa dhe kështu u mbyll edhe ndonjë gojë e ligë, që zgjati gjuhën e tha se Kili nxori inat meqë kishte ngelur i pangopur nga darka e mikut.

Me të marrë vesh Kili Rrumbullaci se nusja e Kic Lipes i thërriste «mace» së vjehrrës dhe se vjehrra e Naje Silindinit i tregonte asaj çomagen e s'e linte të bënte gëk-mëk, me vrap u sul në derë të një-rës e të tjetrës.

— Për emancipim — iu betua Kili si njerës ash-tu edhe tjetrës — po nuk mblodhët fiqirin, di unë se ç'bëj!

Dhe ndonjë tha:

— Mirë ua bëri! E duan nganjëherë nusët pipe-rica dhe vjehrrat zevzeke.

Kur shpiku Kili Rrumbullaci betimin e ri «për emancipim», shumë nga ne, bashkëfshatarët e tij, e pëlqyem fort e nisëm ta përdornim më të madh.

Ishim të gjithë në një mendje, se edhe djalit, që do t'i lindte së shpejti, Kili do t'ia vinte me siguri emrin «Emancipim». Dhe po bëheshim gati që, me t'i lindur, «Emancipimi», ta propozonim Kilin për dekoratën e klasit të parë të luftëtarit të flaktë të emancipimit. Këtu pati dy mendime. Një palë thoshin të mos prisnim sa t'i lindte e shoqja, se ajo s'ishte shtruar ende në maternitet. Të tjerët thoshin që për dy — tri ditë ajo do të shtrohej, se barku i kishte shkuar te buza. Pas shumë debatesh ne vendosëm të pregatisim dokumentat e dekorimit. Morëm masat edhe për ceremoninë. Do të jepej një program i veçantë ditën e dekorimit të Kili Rrumbullacit tonë të shtrenjtë.

Një ditë të gjithë u vunë në kërkim të Kilit.

— Kili urgjent në telefon! Kryesia e Bashkimit të grave të rrethit!

— Gjeni Kilin, ore!

Njerëzia hynin e dilnin nga dera e PTT-së së fshatit. Kili këtu, Kili atje! Më së fundi mezi u gjet Kili në shtëpi.

Njerëzia prisnin kureshtarë te dera e PTT-së.

— Ore, pse e kërkojnë me kaq axhele?

— Kushedi, do t'i bëjnë dekorimin.

— Ama fole edhe ti! Pse, me telefon bëhet dekorimi?

— Mos është ndonjë gjë e madhe, thuaj!

— E ç'të jetë?

— S'dihet! Për meritat që ka Kili, nuk është çudi ta emërojnë me përgjegjësi në BGSH...

— Ua! Si është e mundur?! Ai është burrë, s'ka triskë anëtarësie të organizatës së gruas!

— E po diçka e madhe është në këtë mes.

Në këto e sipër doli jashtë telefonistja, që s'po e mbante dot gazin.

— Moj, ç'ke? Folë! — i thërrishin! njerëzit nga padurimi.

Ajo mezi arriti e tha:

emancipimi
NË MBLEDHJE



NË FAMILJEN E VET

— Kili po bën autokritikë në telefon. Heshtni e dëgjoni!

— Shshsht! — fishkëlleu dikush.

Dëgjohej bukur e qartë autokritika e Kilit:

«...e po s'kisha si bëja ndryshe, moj motrani! Ja, më thoni edhe ju; sikur ta kisha shtruar, me ato drej rregullash që kanë, ajo do të dergjej plot shtatë ditë e shtatë netë atje, kurse unë do të rrija vetëm me kalamajtë në shtëpi. A e dini ç'i thonë shtatë ditë e shtatë net? Të më dilte myku mua, i thonë, e t'u binte plasja kalamajve. Do grua shtëpia, moj shoqe! Ti sikur s'je grua për vete! E po ja, që e bëra unë tani, mos e bëni dhe ju kaq të madhe, de! E po s'e kishte për herë të parë, jo. Ajo ka lindur një karvan dhe asnjërin në maternitet. Ua di më mirë se mamia atyre punëve, ajo. Ja, si molla është. Ju betohem, që ditën e dytë qiqër më këmbë, pastroi e lau, fshiu e leu...»

Këtu sikur iu pre fare fryma Kilit dhe më tutje nisi të belpëzonte në telefon:

— Ashtu është, e pranoj, dakord xhanëm, posi — posi....

Dhe në fund e mbylli:

— Jo, nuk e përsëris, se s'kam ndër mend as të bëj fëmijë më, as të hyj në gojë të grave.

Dikush nga njerëzit që gajaseshin jashtë, thirri:

— E mbylli dhe Kili me «Emancimin»!

«MODERNËT»

— Këmbët e shpejta e faqja e bardhë — thoshte Nürja.


— Shtatë hile, një trimëri — ulte kurrizin Shemja.

— Ashtu është! — aprovonte Zalua si njërin, si tjetrin. Dhe s'kuptohej me kë ishte, me këmbët apo me hiletë.

Nürja me veshët llapushë, mbronte tezën e këmbëve e s'bënte asnjë lëshim, (dikur kishte pasë qenë vrapues i dalluar në krosset e vjeshtës e të pranverës. Shemja me qafën e zezë rrathë-rrathë ngulte e nuk shkulte për precedencën e hileve mbi trimërinë, sepsë ia kishte parë hairin përherë. Para çdo rreziku ai mblidhte qafën si fizarmonikë dhe fuste kokën në gjoks. Në atë pozicion kurrizi i tij dukej tamam si i breshkës. Kurse Zalua i gjatë si ai plepi, që botanistët e quajnë «populus tremula», luhatej e anohej në drejtim të kundërt të erës më të fortë.

— Ashtu është! — i buzëqeshte Shemes për raportin midis hileve e trimërisë. Dhe fësh-fësh i fësh-fërinin fletët.

Mirëpo kur vërsulej Nure këmbëshpejti, fletët e Zalos shushurin në drejtim tjetër.



— Ashtu është! entuziazmohej pas Nures.

— Bëhej fjalë në këtë mes për «qëndrime parimore.» Dhe askush nuk tundej nga e tija. Megjithatë ata të tre shkonin mirë. Ky ishte një ballafaqim midis specialistësh.

Nurja ishte regjizori. Shemja dirigjenti. Zalua piktori. Të tre emrat e tyre, të shkruar pranë njëri-tjetrit gjithmonë me ngjyra të ndryshme, spektatorët i lexonin çdo tremujor në afishet e mëdha të estradës lokale dhe i kishin mësuar përmendësh.

I pari kishte ardhur Zalua në estradë. Prandaj dhe e vetmja mburrje e tij ishin flokët e rënë. Nuk dihej ç'kishte pasë qenë para dhjetë vjetve, rapsod apo aktor, korist apo balerin. Sidoqoftë ai meritonte respekt, sidomos kur shprehej edhe vetë se për artin i kishin rënë leshtë e kokës. Pas tij erdhi Shemja. Ai kishte mbaruar Liceun artistik në degën e arteve figurative, por nisi t'i binte fyellit në orkestrën e estradës dhe më vonë, për virtuozytetin e tij e caktuan dirigjent. I fundit erdhi Nurja, që mezi mbaroi shkollën e lartë për aktorë. Natyrisht u prit si ujët e pak-të, që mbahet në pëllëmbë të dorës.

Si regjizor i ri Nurja kishte kërkesa të reja. Kjo ishte më se e natyrshme. Ndonjë i ra nër këmbë.

— Urdhëro e folë, se ne këtej kaq kemi ditur, kaq kemi bërë.

— Do të flas e ç'të folur! — thirri Nurja.

— Ti, Zalo, me gjithë respektin e madh që kam për leshtë e kokës që të ka rënë, jepi fund atij natyralizmit tënd e më hip në skenë trembëdhjetë podiume!

— U habitën të gjithë pse e filloi regjizori nga podiumet. Por Nurja dinte ç'bënte.

— Ti, Sheme, lëre mënjanë atë fyellin tënd! Merru vetëm me dirizhimin! Ama orkestrën të ma pas-trosh nga kiuvijet e violinave e zhuzhutë e fizarmo-nikave dhe ta freskosh me buritë më moderne! Dau-llë të porositësh një tjetër të madhe me diametër trem-bëdhjetë metra! Qartë?

— Para autoritetit të ri ende të panjohur të Nures, Shemja mblodhi qafën si fizarmonikë dhe futi ko-kën në gjoks. Pëshpëriti lehtë:

— Qartë!

— Pastaj Nurja ktheu parafangot e veshëve nga trupa dhe urdhëroi:

— Në podiumet e skenës sime tani e tutje ndalo-hen rreptësisht të hipin shallvaret e qeleshet, musta-qet e kërrabat, linjat e qëndisura e futat e më the e të thashë nga ato vjetërsirat popullore. Skena ime mo-derne duhet të shkëlqejë nga xhinglaminglat verbu-ese e nga këmbët e zbathura me fustane trembëdhje-të pëllëmbë përmbi gju...

— Në këtë çast aktorja më e shkurtër u thartua në fytyrë.

Nurja shpërtheu me indinjatë:

— Ja fanatizmi me brirë! Shikojeni! E ç'pret spektatori i varfër pastaj të edukohet nga kjo shoqe që i thotë vetes artiste, dhe e ka mbuluar kokë e këm-bë myku i konservatorizmit?

Njera nga aktoret u hodh e tha:

— Nuk e ka nga turpi kjo, e ka nga halli. Trem-bëdhjetë pëllëmbë është e tëra në këmbë. Sipas modës që thatë ju, fustanin duhet t'ia mbajë një ving nga koka e lart.

— Aty ndal! — kërcëu Nurja i frymëzuar. — Ide e mrekullueshme! Doli titulli i premierës: «Vaj-

za trembëdhjetëpëllëmbëshe dhe fustani në vinç». A s'është kjo jeta jonë moderne, dhe vinçi simbol domethënës? E hatashme?! E ku e kishim fjalën?

— Te trembëdhjetëpëllëmbët — tha dikush.

— Trembëdhjetëpëllëmbët po se po, por... dreqi e mori! Hë! E kishim fjalën të ndalesat e rreptësishtme. Në podiumet e skenës sime ndalohet rreptësisht të hipin rolet mbi tridhjetë e tre vjeç. S'ka role nënash e baballarësh, dajosh e zhashallarësh. Gjyshëri e gjyshesh, jo se jo. Jashtë konservat nga podiumet e mia! Qartë?

Kështu zuri fill e mori rrugë dikur premiera e Nures «Vajza trembëdhjetëpëllëmbëshe dhe fustani në vinç». Trupa, gjatë provave pëshpëriste:

— Sikur s'po marrim vesh fare se ç'luajmë e ç'themë në skenë.

— Djalli e mori — thoshte tjetri — as njëzet e pesë vjeçët s'i kam mbushur. Mos u konservova vallahë?

— Shët! Se është punë vidhash, kjo.

— Shët! Se të nxjerr fishek nga dritarja e të flak si kuti e zbrazët konservash — tallej trupa.

Ditën që doli afishja e madhe trembëdhjetëngjy-rëshe në mes të pazarit e premierës së Nures, njerëzit grumbulloheshin pranë saj, hiqnin e vinin syzet e s'e lexonin dot. Zaluja e kishte qarë porosinë e Nures për një afishe moderne, që të bindej dreqi e i biri për mrekullirat që do të shihte.

Dhe vërtet dreqi e i biri ngelën pa fiqir në kokë, kur u hap sipari. Shemja kishte grumbulluar të gjitha llojet e buri në orkestër. Përveç bandës, kishte mbledhur edhe buri nga ato të pajtonëve të dikur-

shëm, që tanimë kishin ardhur përsëri në modë, buri-të e çetave të pionierëve nëpër kampet e pushimit, buri automjetesh të markave nga më të ndryshmet, edhe buri zjarrfikësash. Daulla të shkulte lukthin e barkut dhe ngrinte pluhurin e skenës, duman. Përmes resë së pluhurit doli një vajzë me fustan të shkurtër dhe nisi të dridhej e të përdridhej, si nga ethe e gu-shtit. Disa nga salla filluan të mblidhnin buzët. Kër-citën dyert. Ca dolën, ca hynë. «Ga-ga-ga!» — qeshën nga një cep tjetër. Fundi i muhabetit e i premierës u përhëndet e u duartrokoi nga një grup kalamajsh që i kishte lënë portieri të hynin për të mos ngelur salla fare bosh.

Në fjalën e analizës, Nurja, i kënaqur për suk-sesin, tha:

— Megjithëse njerëzit ikën nga shfaqja për nde-shjen ndërkombëtare të futbollit që jepte televizori, për mendimin tim suksesi që i plotë. Duhet ditur se spektatori nuk mund ta kuptojë lehtë artin tim. Pre-miera ime shënoi një hap të ri në rrugën e moderni-zimit të artit estradesk.

Kur Nurja arriti në hapin e trembëdhjetë të kë-saj rruge «moderne», aktorë e spektatorë, të bërë te-lef, me nga një kaçavidë në duar, i vunë përpara me Nure, me SHEME e me ZALO, për t'u shtrënguar vidhat.

Llapat e veshëve të Nures e thithën rrezikun si radar. Shëmja i dha një laps raportit midis hilëve e trimërisë, mblodhi qafën si fizarmonikë dhe nxori kurrizin si mburojë. Zalos, midis tyre iu drodhën fle-tët. U mblodhën kokë më kokë.

— Këmbët e shpejta dhe faqja e bardhë — tha Nurja.

— Shtatë hile, një trimëri — uli kurrizin She-
mja.

— Ashtu është — aprovoi Zaluja majtas e djath-
tas.

Por këtë radhë s'bëhej shaka. I kishin mbër-
thyer keq.

— — — — —

[Faint, illegible text, likely bleed-through from the reverse side of the page]

RRENJË

Kishte dhjetë vjet që haheshin gjysh e nip.

— Nuk shkulet, o bir, jo, më se shkulet zemra!

— E ke kot, o gjysh! Na e ka marrë të keqen me kohë!

Dhjetë vjet më parë gjyshi ishte tetëdhjetë vjeç. Edhe tani, që shkeli në të nëntëdhjetat, është po ai. Sikur dhjetë vjet më tepër të paskeshin qenë për të vetëm dhjetë ditë. Kokën e ka postiqe të bardhë, kockën e damarët të fortë, sytë pishë. Veç me veshët ndjehet pak i rëndë.

I qeshur e hokatar, vetëm me një dhëmb në gojë, që e përdor si sqepar për të shqitur ndonjë copë mish apo për të gërryer e copëtuar ndonjë ftua apo thelb arre. Nuk ka provuar asnjë ilaç, asnjë inxheksion, asnjë doktor. Mban mend vetëm tri sëmundje në jetën e tij, të tria në hënë ramazani, me agjërime në gojë.

— Tri herë ai ramazan ka dashur të të çojë në depot e duhanit! — e ngacmonte sa herë i nipi.

Daj Bimi hakërrohej:

— Laj gojën, ti, haram, kur të përmendësh ramazanin!

— E ke kot, o gjysh... — niste nipi.

— E keni kot ju, që haheni më fenë -- i jepte fund muhabetit gjyshi.

Erdhi koha e iu vu fshesa kishave e xhamive. Dhe daj Bimi e preu avazin e tij e nuk ngulte këmbë më me atë shkuljen e zemrës. S'i vinte mirë t'u nxinte faqen njerëzve të shtëpisë e t'i vinte njollë derës së tij.

Daj Bimi s'ndjehej i gjallë. As shfaqej i gëzuar, as i hidhëruar. Po një herë se si ia hodhi me të djegur i nipi atë llafin që kishte përsëritur dhjetë vjet rresht:

— E pe, gjysh, se si doli fjala ime? Na e mori të keqen feja! As nam as nishan s'i ka mbetur më!

Daj Bimi ia preu:

— Jo, ore çun, jo! Më se shkulet zemra...

Nipi qeshi me gjyshin inatçi e s'e ngacmoi asnjëherë më. Iku një hënë e hyri një tjetër sivjet dhe daj Bibi zuri shtratin. Lëngoi keq tri ditë, po doktor s'pranoi që s'pranoi. Kjo sëmundja e katërt pas-kësh qenë më e madhja. Daj Bimi u bë petë. Natën e katërt as merrte as jepte më. Nipi në mes të natës doli e solli dy mjekë në shtëpi.

— Sa vjeç është?

— Nëntëdhjetë.

Mjekët vunë buzën në gaz. Megjithatë nxorën e lanë recetën për penicilina e streptomicina dhe u ngritën e ikën. Nipi çau dhenë nëpër fqinjë, sa gjeti një flakon penicilinë e një streptomicinë. Ngriti nga glumi dhe një infermiere.

E gjithë familja atë natë përgjonte daj Bimin. Plaku s'jepte asnjë shenjë.

Dhe kur agimi feksi në shpinën e kodrave, fek-
sën edhe sytë e daj Bimit. Hapi qepallat, rrotulloi ko-
kërdhokët e tha:

— E, qysh jeni? Ç'paskeni sot që qenkeni ngri-
tur me natë?

Ç'ishin rreth e rrotull krevatit zgurdulluan
sytë.

— Ore, pse s'flisni? Mos është gjë sëmurë njeri?
— pyeti plaku.

— Ja, ti, baba, je sëmurë! Qysh u gdhive sot?
— pyeti me gjysmë zëri e para nusja e madhe.

Të gjithë u habitën se sa mirë e dëgjoji plaku atë
gjysmë zëri që mezi e dëgjuan veshët e tyre të
mirë.

— Unë s'kam gjë më — qeshi daj Bimi — sot do
të çohem të shkoj në zbor!

Të tjerët s'merrnin dot veten.

— Ti, nuse e madhe, më bëj gati bukën se do të
dal vërtet.

— Bukën!? — pyeti nusja e habitur.

— E, e, bukën të thashë edhe hiqmuni sysh të gji-
thë! Më lini vetëm me këtë!

Daj Bimi zuri për flokësh nipin e ia shpupurisi.
Sa dolën të tjerët, plaku u ngrit ndenjtur dhe tërhoqi
pranë vetes nipin.

— Sonte fitove, qerrata! — tha.

— Ç'fitova, o gjysh?

— Atë davanë e madhe që kemi patur bashkë,
ore. Më fitove mua, të them. Më solle dy doktorë.
Unë merrja, po s'jepja dot, se do t'i kisha përzënë që
të dy. Do t'i kisha vënë drunë edhe asaj infermieres.

Syfyri kishte kaluar dhe ajo gjilpëra e asaj ma prish-
te ramazanin.

— Ramazanin?! Ç'ramazan, gjysh?!

— Ç'kujton, se mos kam lajthitur? E kam top
mendjen! Njëzet e pesë ditë që mbaj ramazan unë,
et'i s'di gjë. E kam mbajtur që dhjetë vjeç. Sonte për
herë të parë në jetën time ma prishe ti me ata dok-
torët e me infermieren.

Daj Bimi psherëtiu thellë.

— Më se shkulet zemra... Kam pasur hak, apo jo,
o bir? Ju të gjithë kujtuat se, qëkur u prishën xha-
miat, u shkul edhe feja nga zemra ime. E po jo de,
jo! Ramazanët i kam mbajtur radhë e ju s'dini gjë,
veç nuses së madhe që më binte syfyryn. Kur binin
bajramet në festat tuaja, ju hanit ëmbëlsirat e prit-
nit e përcillnit vizita për festë, unë haja ëmbëlsira
e pritja e përcillja atë tarafin tim të fesë.

Nipi ia plasi gazit:

— Po kur s'takonin bajramet me festat?

Edhe daj Bimi qeshi me atë dhëmbin e vetëm në
gojë:

— Aq ta priste ty e të tjerëve, për ëmbëlsira!
Kur binte bajrami në dimër, bëhej për të ëmbëlsuar
dimrin, kur binte në kohë tjetër, nusja e madhe për
hatrin tim gjente gjithmonë nga një yçkël. Sikur ve-
tëm ramazanë bajramë... të gjitha qokat i bëja
unë.

— Po më, gjysh? Pa hë, gjysh!

— Ç'i do të tjerat? Ajo gjilpëra e shkencës i thau
edhe ato rrënjët e fshehura në zemrën time. Ramazan
e kuran qenë duke më fshirë. Ajo gjilpërë më bëri
karafil. Më solli edhe veshët, pa le! Të humburit ne!

KRYETARI NUK HA SILAZH

Ai ua tregonte në klub shokëve të tij pensionistë këtë histori, që i kishte ndodhur një herë e një kohë, kur kishte qenë kryetar kooperative:

...Pse, a kthehesha unë në atë krah!

— Kryetar, përfunduam studimin për nevojat ushqimore që duhen siguruar për çdo kafshë gjatë gjithë vitit.

Unë i jepja mbi sy kapelës me strehë e u thosha:

— A s'keni punë ju, që luani derën?

— Kryetar, baza ushqimore për kafshët është toka.

Unë buzëqeshja:

— Ma keni mësuar përmendësh këtë avaz, o vëllezër!

— Kryetar, në kushtet e reja, ku gjedhi, derri dhe shpendët bëjnë regjim stallor...

Ktheja shpinën unë dhe ua lija fjalën në gojë:

— Pa, pa, pa! Paskeni qenë të tmerrshëm! S'e lini tjetrin të marrë frymë!

— Kryetar, pa zhvillimin e lopës ekonomia nuk ecën e sigurtë.

Unë edhe inatosesha:

— Amani, se më çmendët! Sikur s'i di unë këto!

— Kryetar, foragjeret i kemi lënë në mëshirë të fatit. As shërbime agroteknike, as gjë prej gjëje. Gjynah toka! Nuk po shfrytëzohet...

Unë krekosesha e pëshpërisja me vete: «E, aty po më rreh mua, posi! Më tjetër anë e kthej syrin unë, nga bimët e arave». — Dhe fap e lëshoja mbi sy kapelën me strehë.

— Kryetar, pse vazhdojmë të mbjellim panxhar foragjer, kur me shalqinin foragjer marrim rendiment më të lartë?

Unë i bija shkurt:

— E kam hallin te shalqini për njerëzit, o byrazer. Lërmë rehat me ato që më përrallis!

— Duhet të shtojmë pa tjetër sipërfaqet e mbjella me jonxhë, kryetar. Jonxha është për gjash-të muaj ushqim i njomë dhe bar i thatë për gjash-të muajt e dimrit. Jonxha është mielli proteinik e vitaminoz për viçat, për derrat, për shpendët. Jonxha është baza e prodhimit të qumshtit e të mishit...

E unë tallesha:

— A ke më? Të qenka bërë mendja jonxhë, o i shkretë! Se mos të del jonxha edhe në ëndërr! Po për drekë, jonxhë do të hash?

— Silazh, kryetar, silazh. Jemi keq me silazhin... Degët e misrit i kemi lënë fushave. Nuk po e vlerësoni hiç, kryetar!

E unë rrihja gjoksin:

— Kujt i thua, more? Nuk ke sy e veshë të shohësh e të dëgjosh, se si e lavdërojnë gjithandej këtë kryetarin tuaj? Në vend që të thërrasësh «suksese, suksese!» e të të dëgjojë gjithë bota, të ra gjuha për-dhe «silazhi, silazhi!» E ç'është silazhi përpara sukseseve që kemi?

— Kryetar, mos e shihni blegtorinë me syrin e njerks!

E pse, a kthehesha unë në atë krah?

«Suksese kemi, lavdërime kemi, të gjitha të mirat i kemi... por kur pula s'kemi, pse të bëjmë ish?!»

E mua, kryetarit të tyre babaxhan më qeshte nuri. Vetëm kur vrehëj pak koha, më dhimbte shpatulla. Dhe ankohesha:

«Ah, kjo blegto... kjo reumatizma!»

Jepnin e merrnin të më mbushnin mendjen, se blegtoria nuk është reumatizëm, po pse, a dëgjoja në atë vesh unë? Jo, besa, jo. Vërsulesha me bateritë e sukseseve dhe fap i jepja mbi sy kapelës me strehë. Dhe kapardisesha a s'kapardisesha.

Më erdhi një ditë në zyrë brigadieri i fermës. Gulçonte ai nga gëzimi e nga vrapimi.

— Kryetar, kam gjetur një lloj fare shalqini, që kokrrën më të vogël e bën një çerek kuintali!

— Jo, more! Po ku kështu?

— Histori e ngatërruar, kryetar. Po ku ta mbjellim?

Mua më hëngri meraku:

— Ore, për shalqinj lopësh më flet ti? Shko tutje, se s'kam nge!

— Jo, kryetar, për shalqinj njerëzish. Po ku ta mbjellim, më thuaj!?

— Oj, ku ta mbjellësh! Edhe pyet? Në ata pesë hektarë që...

— Do t'i mbjellim me jonxhë ata, shoku kryetar!

— O po më plasët me këto jonxhëra e silazhëra e foragjere e dreq! Urdhër: Të mbjellësh

shalqinin, që kokrrën më të vogël e bën një çerek kuintali!

— Si urdhëron, shoku kryetar!

U mboll shalqini dhe kokrrën më të vogël e bëri një çerek kuintali. Unë në kulmin e gëzimit i telefonova tregëtisë:

— Ejani të merrni shalqinj që, kur t'i shihni me sy, t'ju bjerë të fikët! Vetëm për eksport i kemi!

I dhashë mbi sy kapelës me strehë e iu ktheva agronomit:

— O çun, po deshe, një kokër gjysmëkuintalëshe dërgoma në shtëpi! E ka, apo s'e ka hak kryetari juaj ta provojë i pari atë birçe shalqini, që do të na e mbushë arkën plot?

— E ka — tha agronomi.

Siç e mora vesh më vonë, pas shpinës sime agronomi u kishte telefonuar atyre të tregëtisë:

— Kryetari bëri shaka, shalqinj për eksport nuk kemi.

Sime shoqeje filluan t'i rridhnin djersët çurg, kur deshja ta priste gjithë atë shalqi të madh. Shalqini nuk pritej që nuk pritej.

Kur shkova për drekë në shtëpi, ajo më tha me gesëndi:

— Ama, shalqi, o burrë...

— Ehe! Eksporti! — u krekosha unë.

— Eksport i papjekur! — u tall ajo.

— Di gjë ti! Sillma këtu thikën!

— Thika s'e pret, po merr më mirë naxhaken!

— Thikën, moj, këtu!

— Dhe i hyra unë shalqinit sa lart poshtë e ijas. Pse, pyeste ai për thikën!

— Auf! Ç'është kështu!? — turfullova unë telef e ujë në djersë.

Mora satërin e i hyra bamp! Shalqini kërciti e mori të krisur. Bamp! Ç'më panë sytë! Ai ishte shalqi lopësh. Gruaja gajasej e kakariste.

Unë vura duart në kokë:

— Më çmendën foragjeret, më hëngri të gjallë blegtoria! Ooo shpatulla! Pale me ata të tregëtisë... Kush ma punoj këtë reng, shtrenjtë do të ma paguajë!

Po kur arrita deri te zyrat e kooperativës, zootekniku më dha lajmin:

— E tejkaluam planin e qumshtit. Njëqinda e njëzet për qind, kryetar!

— Je në vete?! — pyeta unë i habitur.

Më se bënte gjeli vezë, aq realizohej plani i qumshtit, prandaj kisha hak unë të habitësja aq shumë me lajmin e zooteknikut.

Dhe pyeta:

— Si the, o çun? E kush e bëri këtë mrekulli? Zootekniku qeshi e tha:

— Ai shalqini, që kokrrën më të vogël e bën një çerek kuintali!

Desha s'desha, qesha dhe unë.

Zootekniku tha:

— Po vjen dimri, kryetar. Jemi keq me silazhin...

— Merrni të gjitha masat — i thashë — veç mua në shtëpi mos më ngatërroni! Kryetari nuk ha silazh. Më turpëruat! Hej, ç'më bëtë me atë shalqi!

Pensionistët rreth tyre zës qeshnin. Ai e mbyllte historinë:

— Ama më kanë dashur të gjithë fort. Kokën

linin për mua. Goxha merita kisha. Në punë copë-
tohesha. Suksese po kishim. Përndryshe do të ma
kishin vënë drunë. Por ja që për silazhin s'haja
që s'haja sëpatë. Tani ndryshe është. Ne në kohën
tonë e kishim vetëm me eksperiencë, tani kryetarët
janë edhe me shkencë...

LET R A T

Ja, kjo më duhej! Sikur ta kisha porositur këtë letër. Sa mirë që qenka puna kështu. Që tani do të shkoj t'ia tregoj sime motre dhe të qetësohet. E shkreta, ka tri javë që vuan. Dashuri vërtet por, kur të përbuz tjetri, jo, moj motër, e ke kot, nuk i puthet këmbë e dorë. E dashuron ti? Mirë, të kuptoj, mezi shkulet ajo dashuri e shkretë, po ama tani, kur të lexosh këtë letër, vë dorën në zjarr se fije rrënje s'ka për të të mbetur në zemër nga kjo dashuri. Dhe ai mistreci, pale, po na hidhte edhe vickla. Kishte tri javë që u nda nga ime motër. Ngadalë, more djalë, u dashka të jetë ime motër ajo, që duhet të të thotë sikter ty, e jo ti asaj. Pa të lexosh një herë këtë letër, se ç'thuhet për ty!» «Unë s'ju kam gjë ju, kurse djalin e njoh. Për vajzën, kemi dëgjuar fjalët më të mira, ndaj më vjen keq, që po merret nëpër këmbë. E kujt po ia jepni? Një palaçoje, që është ngatërruar me kushedi sa vajza!» Hajde këtu, motër!

Motra lexon letrën dhe në vend që të kthjellohet po ngriset më keq. E po budallaçkë që bëhet! Ende i qan zemra për të! — Sa të mbarosh së lexuari, bën mirë të mbledhësh mendjen.

— S'është e mundur! Kjo është shpifje, vëlla!

Unë e njoh mirë Kiun. Ky që shkruan këtë letër gënjen.

— Mo, po kaq të janë errësuar sytë? Ky që e shkruan letrën as na njeh, as na ka gjë. Ne duhet ta falënderojmë, ti thua shpif!

— Shpif, shpif, shpif... Ja!.

— Unë kam qenë përkrahësi më i zjarrtë i dashurisë sate, po kam të drejtë të të them se ty s'ka ç'të duhet një djalë që të kthen shpinën pa asnjë shpjegim dhe për më tepër kur na del se është vagabond.

— Jo, vëlla, për Kiun ky shpif. Ma ndjen zemëra, kupton?

— Po atëherë pse i prish punët me ty? Hë, folë!

— Nuk e di.

— E po mos u bëj çilimi! Çdo gjë është e qartë dhe ti duhet...

— Jo, të lutem, jo, mos e thuaj atë që ke ndër mend! Ma jep këtë letër mua! Do ta sqaroj këtë punë se s'bën. Le të mos më dojë më Kiu, veç shpifjen që bëjnë për të do ta zbuloj.

— Kaq e do, moj e uruar?!

— Ma jep letrën!

— A ke besim tek unë? Dëshirën tënde do ta çoj në vend unë. Po pati shpifje në këtë mes, do ta zbuloj se s'bën. Vetëm diçka dua nga ti. Mundohu të qetësosh veten! Nuk të shoh dot kështu të vrrarë shpirtërisht.

* * *

— More Liko, dale, more, se as jemi vrarë, as jemi prerë. Pse ma drehd rrugën kështu?

— E po...

— Jemi burra, apo çiliminj, ç'domethënë kjo?

— Shiko, ti, byrazer, në qoftë se këtë punë e përishtë im vëlla, unë nuk mund ta ndreq. Tani ç'kërkon ti nga unë? Me zor s'bashkohen njerëzit!

— Kush po kërkon t'i bashkojë me zor?

— Ja, ti. Im vëlla të la motrën, dhe ti vjen e më kërkon llogari mua!

— Liko, nuk ta kam borxh këtë fyerje!

— Po unë, borxh ta kam kërcënimin?

— Ç'kërcënim, more?

— E pse ma pret rrugën, pra?

— Të sqarohemi, o Liko!

— Sqarimin e kam këtu në xhep unë!

— Çfarë sqarimi ke në xhep ti, more? Ngadalë, e mos na u krekos si kokoshi në thekër! Po të qe për në xhep, e kam unë sqarimin aq të bukur, sa s'bëhet më! Por ç'ti bëj asaj sime motre!

— Atëherë shko te jot motër e lërna rehat!

— Mbjaj gojën ti për time motër!

— E po s'desha të ta thosha, ore byrazer, por ma bëre borxh. Vajzë të tillë, si jot motër, nuk fusim në shtëpinë tonë. Kërkon sqarime më? Hapma rrugën!

— Liko, Liko! Merre mbrapsht atë që the, se përndryshe ta hëngra gurmazin këtu ku je!

— Se mos e thashë unë i pari. E thotë gjithë bota.

— Çfarë thënka bota, more, more...

— Ngadalë, se s'ta ka frikën njeri. Bota thotë atë që është.

— More çfarë? Thuaje! Burracak!

— Oj të thënë! Ja, dëgjo. Bishtdredhur!

— Bishtdredhur ime motër?! Ti qenke shpifës i ulët!

— Mbaj gojën, se njera bëhet këtu tani! Do fakte?

— Ç'fakte, more? Po ti e di fare mirë se e yetmja dashuri e sime motre ishte për vëllanë tënd.

— Kot xhindosesh, ore byrazer. E kam këtu në xhep. Kërkon ta lexosh me sytë e tu?

— Në xhep? Çfarë ke në xhep?

— Letrën.

— Letrën e kam unë në xhep, jo ti!

— Ashtu. ë? Po kësaj ç'i thua? Na, lexoje!

— Po ti kësaj a s'i thënke letër? Bujrëm edhe ti, lexojë!

— Ai fillon të lexojë letrën që i dhashë unë. Dhe unë lexoj letrën që më dha ai.

«Nusja që keni menduar të merrni për Kiun është bishtpërdredhur. Po deshët, pyesni ata që kanë qenë në aksion...»

— O po ç'është kështu?

— Hëde, ç'është?

— Ishte i njëjti shkrim. Ne ngelëm të habitur.

— Hajde, hajde — thashë unë. — Ky është shkrimi i Kollit, që ngul këmbë ta marrë time motër për të birin, Rakon.

Deri ku qenka katandisur!

«PËSIMI» DHE MËSIMI

— Lërna rehat, o Lame! Sa herë të kam thënë, shkenca do kokë e shkollë të madhe.

Ishte e pesta a e gjashta herë që Lamja rrekej me eksperimentime dhe gjithmonë i kishte vajtur mundimi huq. Dhe tani brigadieri jo që s'i besonte më, por kishte filluar edhe të tallej. Edhe vetë Lamja këtë radhën e fundit nuk pati sy e faqe të shkonte deri tek agronomi, se gjithmonë i kishte vajtur mundimi huq.

— S'është gjë kjo, o Lame! — thoshte agronomi sa herë që Lamja kujtonte se kishte gjetur diçka të re.

Megjithatë këtë herë se ç'e brente përbrenda (e nxiste dhe i biri), se ky propozimi i fundit duhej të ishte me bukë. Ai kishte vënë re se gjashtë hektarët matanë korijes së vogël ishin njëllor me tokën e oborrit të tij. Për një kohë të gjatë Lamja mbushte grushtet me dhé nga të dyja tokat, u merrte erë, i shijonte në gojë, i fuste në ujë nëpër kanaçe, i kullonte dhe i dilnin të dyja njëllor. Mirëpo në këto dy pëllëmbë tokë të oborrit ai bënte goxha fasule, kurse kooperativa në gjithë atë tokë merrte shumë pak fasule për hektar. Bëri ca llogari Lamja dhe

i doli se, po të hidhej më shumë farë, prodhimi duhej të shtohej pesëfish.

— T'ia themi agronomit — ngulte këmbë i biri — se këtë s'e luan as topi!

Mirëpo Lamja nuk donte të turpërohej më e të bëhej gazi i botës.

— A do që t'ia them unë agronomit? — e cyste i biri.

— Sakën se i thua! — kërcënohej Lamja. — Mjaft u tallën me mua. Ai librat i ka, shkollën e ka, ditë e natë me shkencën merret. Po të ishte gjë ky budallallëku im, do ta kishte gjetur më vakt e me kohë ai ose shokët e tij. Ja, ngeli shkenda tek unë, elifimatraku!

Fatmiri nuk vajti tek agronomi jo nga këto që i thoshte i ati, por ngaqë i shkoi nëpër mend një gjë tjetër. Fasulet e oborrit të tyre ndoshta bëleshin pyll jo pse hidhnin farë më shumë, por ngaqë për ato dy pëllëmbë tokë kujdeseshin shumë. Gjashtë hektarët e kooperativës matanë korijes, sado-sado nuk mund ta kishin as çerekun e atij kujdesi. Këtë e pranonte edhe Lamja, por ai ngulte këmbë se sasia e farës ngre peshën më të madhe. Fatmiri mendoi edhe një gjë tjetër që nuk shkoi tek agronomi.

Kështu sikur vajti huq edhe përpjekja e fundit e Lames. Dhe Lamja iu betua vetëvetes se nuk do ta vriste mendjen më për punë që duan kokë e shkollë të madhe.

Erdhi koha dhe Lamja mbolli fasulet në oborrin e tij. Edhe në gjashtë hektarët e kooperativës hyri maqina mbjellëse dhe hodhi fasulet. Pas një dy ditësh plasi një gurgule në zyrat e llogarisë.

Në tre hektarë nga të gjashtët matanë korijes ishin hedhur dy-trefish më shumë farë fasule!

Si ndodhi? Kush e bëri këtë dëm? Të mbahet procesverbal!

U mbajt procesverbali. Dëmi arrinte deri në treqind lekë.

Dhe më së fundi shkaktari u gjet. Na kishte qenë maqina mbjellëse! Ishte graduar keq dhe kishte lëshuar më shumë fasule në tokë se sa duhej.

— More, po maqina mbjellëse nuk gradohet vetë, por të gjendet shkaktari!

— Dhe si u bë kjo punë vetëm në tre hektarë, kurse në tre të tjerët u gradua mirë?

Maqinisti ngrente supet.

— As unë s'e marr vesh se si.

Brigadierit i vajti mendja menjëherë te Lamja. Ta kishte bërë Lamja këtë punë me kokën e tij?

— O Lame — i tha — ti me atë shkencën tënde duhet ta kesh bërë këtë. Do të t'i bëjmë ngarkim e t'i paguash.

I biri i Lames, Fatmiri, u hodh e tha:

— M'i vini mua në ngarkim. I paguaj unë për mundimin e tim eti.

Lamja iu përvesh brigadierit:

— S'është Lamja nga ata. Lamja nuk bën gjëra tinëz, o brigadier! Pastaj, thirri pak mendjes! Ato dy ditë që u mbollën fasulet unë kam qenë në Tiranë.

Brigadieri kafshoi buzën. Lamja vërtet nuk kishte qenë në fshat ato dy ditë.

Më fal, o Lame, se të rashë më qafë kot!

— Falë qofsh, brigadier!

Fatmiri i thirri nga pas brigadierit:

— Po ngelët keq, do t'jua paguaj unë, shoku brigadier!

E kujt do t'i ngecte procesverbali?

— Do të paguash dëmin, maqinist!

— More, besomëni, unë nuk mbaj mend ta kem graduar keq maqinën. Më plaçin sytë, që më kujtohet fare mirë! Ë gradova mirë, more shokë! Pastaj, po ju ç'bënit? Ja, ti, si brigadier, ç'bëje? Maqina lëshonte më shumë fasule. Dhe kërkonte më shumë. Unë i jepja. Se kujtoja që ishte graduar mirë. Edhe ju më jepnit mua. Edhe magazina ju jepte juve. Hënde! Pse nuk i ratë hilesë së maqinës ju të gjithë e të më thoshit: «Ore ti, ndal, se e kalove racionin! Se mos ma hodhi mua maqina? Të gjithëve na e hodhi! Të gjithë të paguajmë!»

U ngatërrua keq lëmshi. Cili duhej të mbante përgjegjësi? Cili duhej të paguante?

Dhe kjo punë shkoi aq gjatë, sa fasulet mbinë e u rritën, nxorën bishtajat, u poqën dhe u bënë për t'u këputur.

Dhe kur u këputën e u mblodhën, plasi një gurgule tjetër. Tre hektarët, ku kishte gabuar maqina mbjellëse, dhanë nga 35 kuintalë secili. Kurse tre hektarët e tjerë dhanë aq sa jepnin përherë, nga 6-7 kuintalë secili.


Sigurisht procesverbali tanimë ishte harruar. Kërkohej ai që duhej të lavdërohej. Lamja, që s'dinte se si ndodhi që maqina mbjellëse provoi propozimin e tij, nuk u krekos. Kurse të birit, Fatmirit, i kishte hipur një gaz i madh e s'ngopej së geshuri.

NJË LETËR NË FUND TË VITIT

«I dashur baba!

Ky vit për mua u nis e u gris si viti i mallit për ty. Tani që i erdhi fundi dhe kanë mbetur edhe tri ditë, bëra një llogari. Mblodha javët dhe ditët që ti ke ikur me shërbim dhe më dolën 7 muaj rrumbullak. Por mua më duket sikur tërë vitin s'ke ardhur në shtëpi, sepse s'mbahen mend se sa herë je kthyer natën vonë nga shërbimi dhe më ke gjetur në gjumë. Pastaj ke krisur që në mëngjez herët duke na lënë përsëri të dy vetëm me mamanë.

Natyrisht ti si drejtor e ke për detyrë të shkosh me shërbim, se vaj halli ndërmarrja pastaj. Kjo është një sakrificë e madhe për ty e për ne në familje. Kaq herë kisha menduar të të pyesja, pse nuk ta lehtësonin ndopak këtë detyrë ata vartësit e tu. Por mora vesh se, sipas fjalës së urtë «Sheh rrushi rrushin dhe piqet», kërcitkan si ti, me shërbim nga jugu në veri edhe ata vartësit e tu. Çudi pra! Sa shumë shërbime paska kjo ndërmarrja jote, baba! Dhe kështu si jam çuditur unë, si duket qenkan çuditur shumë vetë, në ndërmarrje dhe jashtë saj, dhe kanë filluar të thonë se ty dhe vartësve



të tu ju ardhka mirë që shkoni me shërbim. S'më vjen mirë, baba, kur thonë kështu për ty.

Pa le kur më thanë një herë, se shumica e punëtorëve të dinë vetëm emrin, por me fytyrë s'të njohin. «E si është e mundur kjo», thashë me vete. Harrova për një çast se edhe unë e mamaja, po të mos kishim fotografinë tënde në shtëpi, ishte rrezik të ta kishim harruar fare fytyrën.

Këtu më ndërpreu mamaja. Erdhi e xhindosur nga puna. Lodhet shumë e shkreta, megjithëse unë bëj çmos që ta ndihmoj me pazaret e në punët e shtëpisë. Por duket e ka edhe nga malli për ty.

— Për tri ditë, Viti i ri! — po më thotë ajo. — Asgjë s'kemi në terezi. Kur do t'i blejmë frutat, gjeli, ëmbëlsirën, verën... Shtëpia pa tundur, pa shkundur...

Ajo numëroi shumë gjëra të tjera që s'ishin në terezi, por unë e kuptova se ajo kishte hallin tënd. A do të vish deri natën e Vitit të ri?

— Unë i them: — Mos bëj kështu, mama! Për ato që the, i hyjmë të dy dhe i bëjmë të gjitha për bukuri. Por, po e pate për babanë, interesi i përgjithshëm mbi gjithshka.

Ajo po më shfryn:

— Si the, si the? Pa përsërite dhe një herë! Lapsin në dorë e ke. Futju llogarisë dhe bëje hesapin në daç edhe me minuta e me sekonda për interesin e përgjithshëm. Kur i ndjek planet e ndër-marrjes yt atë? Kur mendon për masat që duhen marrë? Kur jep udhëzime? Kur merret me forcimin e punës organizative? Kur merr mendimin e masës së punëtorëve? Pale pastaj për organizimin e punës ideopolitike e shkencore! A e di ti, se për dymbëdhjetë muajt e vitit, në vend të dymbëdhjetë

rrogave, yt atë ka marrë njëzet rroga? Llogarit po aq edhe për shoferin, shto gomat, benzinën e maqinën, shto dietat...

Mamaja u zbraz një herë e mirë. Ajo s'e di që unë po t'i shkruaj të gjitha ty.

Me të marrë këtë letër, bëj çmos, baba, të na vish të paktën sa për mbrëmjen e Vitit të ri. Tani që po përfundoj këtë letër, m'u shtua më tepër malli, tek po dëgjoj një vaje, që s'po kuptoj se nga vjen, nga mamaja apo nga ndërmarrja:

«Që ditën që ike, që kur s'të kemi parë,
malli se ç'na griu, punët shkojnë zvarrë,
Shumë muaj, u bënë, sot u mbushën shtatë,
Që kur na ke lënë, sa shërbim i gjatë!»

Siç e kupton mirë tani, baba, pas gjelit të detit mprihu të hash ca kritika të majme.

Të presim me padurim.

Djali yt
Kujtimi.

FUSTANI FLUTURUES

Të tria dyert e fshatit, që do të nxirrnin çupat, e kishin marrë vesh se Kalija për çupën e saj e kishte gjetur fustanin. Si e ku e sa, vetëm Kalija e dinte. E zonja ajo!

Dhe u nisën xha Trifi, që nxirrte mbesën, Vangja, që nxirrte të bijën e Sili, që nxirrte të motrën, drejt e në shtëpi të Kalijes.

— Aman, Kalije, motër, si e ku e sa e gjete? S'di si të bëj edhe unë për time bijë! — tha Vangja.

— Derman, Kalije edhe për atë time mbesë! — tha xha Trifi.

— Të lutem, Kalije, ku e gjete ti, t'ia gjej edhe unë sime motre! — tha Sili.

Gjuha e Kalijes si shpatë nisi të presë mbarë e mbrapsht.

— U, u, u! Tigani në zjarr e peshku në det. E ku ka gjetur gjë Kalija? Kalija është në hall për vetë! Ja, thashë një fjalë te pusi unë dhe paska marrë dhenë! Jo, more Trifi, Kalija s'di nga t'ia mbajë për vetë! Jo, moj Vangje jo, moj motër! Jo, ore Sili, jo!

— Të lutem shumë, Kalije! — tha Sili.

— Aman motër! — tha Vangja.

— Derman! — tha xha Trifi.

Kalijes iu zbut zemra, i ndritën sytë. Tha:

— E gjeta dermanin. T'i bëjmë dasmat në një ditë. Kështu po. E rregullon Kalija për bukuri.

— E qysh në një ditë? — pyeti xha Trifi.

— Ja, pas dy javësh që do të nxjerr çupën unë, atë ditë t'i nxirrni edhe ju — tha Kalija.

— Po si ta ujdísim me shtëpitë e dhëndurrëve?

— pyeti i pakënaqur xha Trifi.

Vangja tha:

— Aman dhe ti, o xha Trifi, pyet a e ujdís dot Kalija këtë hall, pa me dhëndurrët e ujdísim se s'bën.

Kalija qeshte e fërkonte duart:

— Mirë, kush të dojë, ndryshe mos i bini më qafë Kalijes!

— Nuk ujdísjet ndryshe? — tha përsëri xha Trifi.

— Jo — tha Kalija.

— Aman, të keqen, si do të bëjmë? — tha Vangja.

— Ç'ishte për të bërë u bë — nisi të presë gjuha e Kalijes — tani të biem në ujdí ne që jemi këtu.

Xha Trifi, Vangja, Sili s'po mërrnin vesh gjë.

— Pse më rrini si të shushatur? Fustanin e gjeta, te njëri në qytet. Të shtunën dy javë do të shkoj ta marr. Treqind lekë, trëng, në dorë. Do ta mbaj të dielën, të hënën do t'ia kthej. Ja kështu. Po ju, ç'më shikoni ashtu si kukuvaika meshkuj e femra?

— Ti e paske ujdísur për vetë, moj Kalije!

— Po hallit tonë?

— Ama, ç'muhabet...
— E po ç'ju thashë? T'i bëjmë dasmat në një ditë.

— Ja, i bëmë — tha xha Trifi i mërzitur.

— E po ja «i bëmë» — u tall Kalija. — ja edhe nusët e veshën fustanin të katra me radhë, ja e ndamë atë 300-lekëshin e na rënka nga 75 lekë për shoq edhe ja ia hodhëm edhe saj matrapazes pispiliqe, që rjep dynjanë me një fustan nusërie!
The gjë më?

— A më të lumtë! — thirri Sili.

— Rrofsh e qofsh, moj motër! — tha Vangja.

Kurse xha Trifi pëshpëriti me vete:

«S'ia ha qeni shkopin!»

Të shtunën dy javë, Kalija me kokën përpjetë u kthye nga qyteti me një valixhe të madhe që s'peshonte fare. Xha Trifi, Vangja dhe Sili po e prisnin me padurim. Hapën valixhen. Në të shtrihej fustani i bardhë.

— Modë e fundit! — tha Sili.

— Edhe 300-lekëshja, që merr ajo, pispiliqja për një ditë, modë e fundit është! — tha Kalija.

Dhe pastaj të katër caktuan radhën e fustanit për të nesërmen.

U trazua dynjaja të nesërmen. Nga dasmat po se po, por më keq nga pouna e fustanit. Ai djall fustani më gjithë ato tylëra, flutura, fiongo mezi vishej e mezi hiqej. Pale kur ngeli tek e mbesa e xha Trifit, se krushqit erdhën me vonesë. Shtëpia e dhëndërrit ishte larg. U zgjat afati nga tri orë që ishte caktuar për ta mbajtur nusja e dytë në pesë. Në shtëpinë e Vangjës, ku do të dilte nusja e tretë plasi sherri e kuja, se krushqit e humbën

durimin. Donin të merrnin nusen, dhe ajo më në fund veshi fustanin e saj më të mirë dhe ashtu u doli krushqve. Tek Sili u detyruan ta qepnin vetë fustanin e bardhë dhe të mos prisnin sa t'u vinte fustani fluturues.

Ndërsa Kalija (ajo e kishte nxjerrë e para çupën) buzë mbrëmjes qante me lot të heshtur ca nga mallëngjimi e ca nga gëzimi. Por iu desh t'i fshihte shpejt lotët, se ia behën dy miq të pafuar nga fshati fqinjë. Të dy kishin dasma të dielën tjetër dhe të dyve po u luante tepeleku i kokës për fustanin e bardhë.

Kalija në fillim u nxeh e i vrau e i preu me gjuhën e saj shpatë:

— Ç'është kjo e keqe kështu? Ç'u bëra unë? Të gjithë tek unë u përpaskan? Lermëni në hallin tim!

Mirëpo lutjet e prekën, kurse inati për pispiliqen matrapaze të fustanit të bardhë i dha një mendje që të gajasej papritmas në sy të miqve hallëxhinj.

— Ojiii! — thirri Kalija. Mendonte se, po t'u kishte marrë të tre dyerve në fshatin e saj dhe të dy dyerve të fshatit fqinjë nga 300 lekë, për dy të diela brenda një jave, ajo pispiliqja zhvaste 1500 lekë!

— Ojii — thirri përsëri Kalija.

Miqtë u shtangën e u trembën. Po kur ua bëri hesapin Kalija dhe rrengun që do t'i punonte pispiliqes matrapaze, ia shkrepën gazit njëri më fort se tjetri.

— Ja — tha Kalija — e ka hak ajo.

Dhe ashtu bëri. Nuk do t'ia dërgonte të nesërmen fustanin, por të hënën tjetër, mbasi të mba-

ronin punë edhe këta të dy. Pastaj i ranë lapsit. Të pesë dyerve të dasmave u binte të paguanin secila nga 60 lekë.

Se ç'ndodhi me fluturimet e fustanit të dielën tjetër nëpër të dyja dyert e fshatit nuk dimë gjë, por thuhet se vetë nuset nazike ishin lemerisur nga kundërmimet e djersës dhe nuk kishin pranuar ta vishnin. Ato ishin rregulluar më së miri me fustanet e tyre.

Të nesërmen Kalija vajti në qytet e trokiti në derën e matrapazes. Fytyrës së egërsuar të pispiliqes, Kalija iu përgjegj me fytyrën e saj krenarë: «Mjaft rrëmbeve nga njerëzit me një copë rrobë».

Se ç'thirri e ç'bëri e ç'shau pispiliqja as që arriti t'i dëgjonte Kalija, se ia përplasi valixhen përpara këmbëve dhe ua mbathi. Zëri i pispiliqes dëgjohej edhe për së largu që çirrej, kurse Kalija me të sajën qeshte e thoshte:

— Ç'ta bëra mirë moj pispiliqe!

Pas ca kohe Kalijen, Xha Trifin, Vangjen dhe ata të dy të fshatit fqinjë i thirrën në një mbledhje të të gjithë kolektivit.

Sa i zuri veshi aty në mbledhje, se qenkësh puna e fustanit, Kalija u krekos e u gufmua dhe po priste që ta nxirrnin në presidium për ta lavdëruar, me që ia kishte punuar aq bukur matrapazes. Por sekretarja e rinisë që po fliste jo vetëm që nuk po e lavdëronte, por urtë e butë po ua ngulte nga një thumb të gjithëve atyre që vazhdonin t'i ruanin këto mbeturina zakonesh me helm fetar. Ky zakon na paskësh mbetur që nga mbyllja e gruas në harem si skllave deri te çarçafi, çatorja, duvaku që e futnin nusen e ia çonin burrit derr në

thes. Kjo qenkësh shenjë e mbeturinës që gruan e quan skllave të burrit. Kjo punë na qenkësh në dëm edhe për shëndetin...

Kalija u pre në fytyrë dhe bënte të thoshte diçka e s'e thoshte dot. I ishte tharë pështyrja në fyt. Më së fundi mezi ia shkrepri.

— Të më falësh, moj bijë, nënë Kalija nuk i dinte këto gjëra! Pika mua, ç'bëra... Tani që i mësova, çupën tjetër nuk do ta nxjerr kështu. Por asaj pispiliqes...

— Asaj mirë ia bëre — tha vajza nga presidiumi.

BËNI NJË FLETËRRUFE!

— Këtë orë nuk do të bëni gjuhë — tha mësuesi — sepse orën tjetër vjen inspektori.

Nxënësit u vështruan sy në sy të habitur.

Por habia e tyre nuk vazhdoi gjatë, sepse mësuesi sqaroi:

— Do të bëjmë prova për mësimin e edukatës morale-politike që do të dëgjojë inspektori. Atëherë, ç'mësim kemi pasur në edukatën morale-politike? — filloi orën e parapregatitjes për inspektim mësuesi.

— «Të jemi të ndërgjegjshëm» — tha njëri.

— Ashtu, shumë mirë! Mbani mend tani që, kur t'ju pyes unë orën tjetër, ju do të ngrini përpjetë që të gjithë pa përjashtim gishtin. Unë do të ngre Liljanën. Ja, kështu. Çohu ti, Liljana!

Liljana u çua.

— Hë, folë — i tha mësuesi.

Liljana u skuq dhe uli kokën. Mezi belbëzoi e turpëruar:

— Unë isha mbrëmë te daja dhe...

— Mirë, moj, mirë — u nxeh mësuesi — nuk do të të ngre në dërrasë të zezë, që të thuash mësimin, por sa për të thënë titullin. Hë, pra, thuaje!

— S'e di — tha Liljana.

— Po ja de, «Të jemi të ndërgjegjshëm!» Nuk ishte këtu ti tani, që s'e dëgjove?

— S'e kam mësuar, mësues...

Klasa ia plasi të qeshurit. Pesë harrakatët e klasës aq deshën, shenjat e para të mjegullës, dhe nisën nga të tyret.

— Sus të gjithë! — tha mësuesi dhe i ra me grusht tryezës.

Klasa ra në qetësi.

— Ju lumtë! Po të ishte inspektori këtë orë, ç'do të thoshte? Turp!

Njëri nga ata harrakatët tha:

— Nuk bëjmë kështu ne, mësues, kur të vijë inspektori.

Disa qeshën. Mësuesi tha:

— Dëgjoni këtu. Ju të pestët në fund, pa dilni që tani dhe zhdukuni! Dhe orën tjetër nuk do të hyni në klasë! Morët vesh?

— Urra, rroftë mësuesi! — brohoritën të pesë harrakatët dhe me vrap dolën nga dera.

— Atëherë — rifilloi nga provat mësuesi — cili nga ju e ka mësuar mirë mësimin e kaluar «Të jemi të ndërgjegjshëm»? Ti, Themis dhe ti, Besnik, do të ngriheni të thoni mësimin. Pa të bëjmë një provë...

Të dy nxënësit recituan mësimin e kaluar. Pastaj mësuesi caktoi tre të tjerë që do të sillnin shembuj nga jeta për një nxënës të ndërgjegjshëm, për një punëtor dhe për një kooperativist. Meqenëse shembujt që dhanë ata nuk ishin të nivelit të lartë për një orë mësimi me inspektor, mësuesi u mësoll tre shembujt të tjerë. Pastaj dha udhëzimin se si

do të silleshin gjatë shpjegimit të mësimit të ri, gjatë bashkëbisedimit. Cakttoi ata që do të përgjegjeshin dhe si do të përgjegjeshin. Dhe prova doli me sukses.

Në një atmosferë ceremoniale nisi ora tjetër e mësimit. Kur hyri inspektori, i shoqëruar nga mësuesi, e gjithë klasa si një trup i vetëm u çua më këmbë. Inspektori përshëndeti dhe zuri vend në një bangë. Mësuesi hipi në katedër.

Nxënësit s'e kishin parë dhe njohur kurrë talentin e mësuesit të tyre të historisë dhe të edukatës morale-politike të shpërthente aq fuqishëm sa në atë orë me inspektor.


Inspektori, madje dhe vetë nxënësit ngelën gojëhapur.

«Mësues më të mirë se ky nuk kam parë në jetën time, mendonte inspektori. Ja se ku e ngre ndërgjegja e lartë një mësues. Do të propozoi ta tërheqim në Institutin e studimeve pedagogjike...»

Por këtu iu ndërpre filli i mendimeve inspektorit. Mësuesi tanimë kishte kaluar në bashkëbisedim me nxënësit, për ta zbërthyer mësimin me shembuj konkretë nga jeta. Këtu ndodhi një incident i vogël. Mësuesi hodhi pyetjen:

— Shoku juaj, për shembull, kopjoi në provimin e edukatës morale-politike. Çfarë do të bënit ju? Do të heshtnit? Do t'i thoshit mësuesit? Apo do ta bindnit shokun që gjatë pushimit të shkojë e t'ia thotë mësuesit gabimin? Cili veprim do ta ndihmonte më shumë shokun tuaj për t'u ndrequr?

Sipas ndarjes së roleve, në vend që të çohet Jani për t'u përgjegur, u çua e paplanifikuar Liljana e tha:



— Asnjëri veprim, zotni, nuk do ta ndihmon-te, sepse ai kopjoi nga ju! — në klasë shpërtheu një valë të qeshurash.

Inspektori s'po kuptonte gjë. Mësuesit kaq iu desh që ta humbte torruan. Nisi t'i merrej goja dhe e pa të udhës t'i jepte fund mësimit me dhënien e detyrave të shtëpisë.

— Tani, për detyrë shtëpie do të bëni një fletërrufe në fletoren tuaj për ndonjë të metë që ju ka rënë në sy.

— Ooo! — thirrën nja dy kokoroça — këtë e bëjmë kollaj.

Tani mësimi kishte dalë përfundimisht nga binarët e provave dhe po improvizohet. Kësaj thirrjeje të papritur mësuesi iu përgjeggj:

— Shumë mirë, pa hë për shembull, çfarë do të shkruash ti, Ilir?

— Do t'ju bëj juve, mësues, një fletërrufe. Ja kështu: «Na mësove që të jemi të ndërgjegjshëm, na mësove të flasim hapur me shokët, por ju vetë nuk folët hapur me inspektorin.»

Në atë çast hynë në klasë pa trokitur të pesë harrakatët dhe thanë:

— Mësues! Po ndenji edhe orën tjetër inspektori, të marrim çar'at ne e të shkojmë në shtëpi?

K R I M B I

Gushtin e kaluar mora lejën e zakonshme dhe shkova te baxhanaku im në Lushnjë. E gjeta midis detit të gjelbër të parcelave të pambukut.

— Mashalla! — e urova. — Ç'pambuk paskeni sivjet!

— Pyll, ore, pyll e kemi, të ka lezet shpirti!

— Po u thyekan bimët prej konxheve — thashë unë.

— Shtatëdhjetë-tetëdhjetë konxhe një rrënjë — u mburr ai. — Ama edhe ne ia bëmë shërbimin sivjet, si s'mbahet mend ndonjëherë. Na pati vënë përpara katër vjet rresht. Jo fara, jo krimbi, jo klima, jo shirat... Fajin e paskëshim pasur vetë.

— As krimb nuk keni sivjet? — pyëta. — se andej nga në kam dëgjuar që çoku ka.

— Aaa! E bëmë tym ne! Tri spërkatje të mira dhe kokë krimbi s'kemi parë të ngrihet. Eja, eja të shohësh! — më tha dhe më tërhoqi mes për mes parcelës.

— E sheh atë hurin që kam ngulur atje? Atje ku ishte ngulur huri, harbohej një bimë e madhe pambuku me majat gjer në gjokset tona.

— Numëroi!

Dhe unë numërova. Tetëdhjetë e pesë konxhe.
— Sa të çelë boçet e para, do ta çoj në kabinetin agroteknik. Kemi kabinet modern.

Një javë të tërë brodha me baxhanakun tim, brigadierin e brigadës së 10-të, që mbahej në gojë në tërë kooperativën për pambukun e paparë ndonjë vit. Tërë brigada ishte e gëzuar.

Vajtëm me baxhanakun të shkullnim rrënjën me tetëdhjetë e pesë konxhe për kabinetin. Boçet e para duhej të kishin shpërthyer. Por për habinë tonë më të madhe bimën e pambukut e gjetëm me kokën të varur. Ishte zhveshur nga konxhet. I kishin mbetur a s'i kishin mbetur nja tridhjetë.

— Ç'ka ndodhur kështu? — bërtiti i alarmuar brigadieri.

Unë kontrolloja për tokë me sy për konxhet e këputura. Vetëm një gjeta. Baxhanaku im, duke turfulluar, nisi të notojë midis detit të gjelbër të pambukut.

— Gjithandej janë zhdukur kushedi sa konxhe! Aman bre, ç'është kështu?! Po më luan tepeleku i kokës...

Vrapuam në një parcelë tjetër. Edhe atje nga bimët kishin bërë firo shumë konxhe. Veçse aty duhej të ishin ngrënë para 2-3 ditëve.

— Të ketë hyrë gjë e gjallë, ndonjë lopë?

— S'ka asnjë gjurmë të tillë!

— E po ç'dreq, pra?! Të jetë shpikur ndonjë lloj krimbi që kullufiska të tërë konxhen e pambukut, pa i lënë nam e nishan!?

Vrapuam të lajmëronim agronomin, kryesinë. Të parit anëtar të brigadës që gjeti rrugës, baxhanaku iu zhgreh:

— Kiu Ziguri, o Kiu Ziguri! Ta kam bërë be-

në kaç herë... Sot marrsh! S'ke punë më në brigadën time!

Tjetri buzagaz ia ktheu më nge:

— Ç'pate, o brigadier, merre shtruar! Mungova, se martova një byrazerkë në Fier!

— Shporrmu nga sytë, të thashë, i pandërgjegjshëm! — ia këputi edhe një herë baxhanaku edhe fryu tutje.

Unë i thashë:

— Ore ç'ke me njerëzit?

— Ma ka prurë në majë të hundës — tha — ky dembel, ky i padisiplinuar, që di vetëm të bre dhë tutje e tëhu!

U alarmua tërë kooperativa. Nëpër parcelat e pambukut po bënte kërdinë një lloj krimbi i çuditshëm. Në vorbullën e këtij alarmi i lashë, kur mbarova lejën e u ktheva në shtëpi.

Një ditë të diel janari dola në pazarin e gjësë së gjallë. Duke shëtitur, më bëri përshtypje diçka. Një lopë me trastë në qafë, nga ato të tagjisë për kuajt, kishte zhytur turinjtë brenda edhe hante. Çfarë shpikjeje! Lopa hante si kalë! U afrova. I zoti m'u duk si fytyrë e njohur.


— S'kam parë lopë të hajë në trastë si kalë! — i thashë. — Sa e mban?

— Shihe një herë, pastaj kërko hesap.

— Mashalla! — thashë. — Lopë e mirë. Po i pëlcitkan gjinjtë nga qumshti — dhe si pa dashur zhyta dorën në trastën ku hante lopa.

Ngriva me dorën në trastë. Konxhe pambuku! Përnjëherësh m'u kujtua Kiu, të cilit i bërtiti atë ditë baxhanaku im. Ishte, dora vetë, Kiu.

— Nga të kemi, o byrazer?



— Do të blesh lopën ti, apo do të më blesh mua?! — qeshi tjetri.

Kot të vazhdoja muhabet.

— Sa? — pyeta kot.

— Tetëmijë.

— Shtrenjtë — thashë dhe bëra të largohesha.

— E po jep ti pazarin tënd...

E lashë më fjalë në gojë dhe u drejtova për në PTT. Ky Kiu na blëka lopë të lira në pazarin e Lushnjës, i ushqeka me konxhe pambuku, u mbushka barkun, u mbushka gjinjtë dhe...

I nisa një telegram baxhanakut:

— «...Krimbi, që kërkon, i përket species së mbeturinave të pronës private. Nuk kanë ç't'u bëjnë preparatet kimike... etj. etj.»



EMBËLSIMI

Më të zbritur nga «Gazi» kryetari na priti përpara zyrave të kryesisë. Përqafoi drejtorin tim, më përqafoi edhe mua. Pas vesës së shiut kishte plasur një vapë e rëndë dhe kryetari na futi menjëherë në zyrën e vet.

U ulëm. Drejtori përballë meje, kryetari në krye të tryezës së gjatë. Në zyrë bente freskët. Kryetari me drejtorin u përshëndoshën përzemërsisht. Biseda filloi në trajtën e ankimeve. Kryetari donte shi. Thatësira po përvëlonte tokat në kodrat. I rrezikohej misri. Drejtori numëroi disa halle të ndërmarrjes sonë.

Ndërkohë hyri një vajzë me dy pjatë në duar. Njerën ia vuri përpara drejtorit tim, tjetrën mua. Vuri dhe nga një lugë në buzë të secilës pjatë dhe iku.

— Urdhëroni! — na tha kryetari.

Dy pjatat ishin plot me mjaltë.

— Në vend të karamelëve, që s'na ndodhen këtu për t'ju qerasur, urdhëroni! — tha kryetari.

Drejtorit i kaluan mornica nëpër trup. Tha:

— Aha! Unë s'e fus në gojë këtë.

Unë ngela me lugë në dorë.

— Jepi, ti, çun! — më tha mua.

Edhe unë aq desha. Mbusha lugën. Më lëshojnë sytë xixa për një çikë mjaltë. I harrova fare drejtorin e kryetarin dhe muhabetin që nisën ata. Të gjithë vëmendjen ma përpiu mjalti. Mjaltë i ri, i mrekullueshëm, qelibar. Dhe unë s'kam të ngopur me mjaltë. Nëpër të dëgjova drejtorin tim që i tha kryetarit:

— Ja, si ky çuni kam qenë edhe unë dikur. Po tani s'e fus më në gojë.

Unë mbushja lugën në pjatën time dhe sytë më kullosnin në pjatën e drejtorit, që rrinte e heshtur midis tryezës.

— Hajde — tha kryetari — ky ditka të ngrënka mjaltë!

— Unë s'e fus më në gojë! — tha drejtori im.

Sytë e mi përpinin pjatën e heshtur midis meje e drejtorit. Pjatës sime po i nxirrja fundin.

— Hë — tha drejtori — po pate fuqi, bjeri dhe kësaj times.

Dhe ma shtyri pjatën tjetër përpara hundës.

— Jepi, jepi, djalë! — tha kryetari. — A, më të lumtë! Ti paske mide!


Drejtori im u kthye kryetarit:

— Qëkur isha kryetar kooperative, ca muaj para se të transferohesha, s'e fus më në gojë mjaltin. Më ndodhi diçka, që s'e harroj.

Kryetari u bë kurreshtar.

Dhe drejtori nisi shtruar. Unë e shoqëroja historinë e drejtorit me nga një lugë mjaltë.

— I kisha mbushur tre vjet si kryetar kooperative dhe kisha lëvizur ca gurë për t'u kthyer në qytet. Familjen s'e kisha marrë me vetë. Ama pu-



noja si kalë. Dhe kooperativën e nxorëm nga prapambetja. Njerëzit ishin të mrekullueshëm. Kishin vuajtur për organizim. Morën rrugë mirë lavdërimet. M'u hap edhe mua syri për transferim. Zura disa kyçe, që mund të çelnin dyert nga varej transferimi im. Njëri nga ata ishte më i shkathëti. I vichej punës ai dhe e nxirrte në krye se s'bën. Ishte nëntor e s'doja të më zinte më Viti i ri në fshat. M'u ngrit mendja. E po duhej ëmbëlsuar pak ai që po përpiquej të më ngrohte krahët, de! Ai do të bënte kaq shumë për mua, unë asgjë për të! Të paktën pesë-gjashtë kile mjaltë në mes të nëntorit nuk ishte ndonjë dhuratë dosido. Miku im edhe sikur të mos ishte aq qejfli i mjaltit, pa tjetër do ta çmonte në mes të nëntorit. Dhashë urdhër të prisheshin tre zgjoj nga të kooperativës... Pas dy javësh më zë derën e zyrës një fshatar. «Shoku kryetar, më bëj derman! Kam nënën shumë sëmurë. Doktori më tha për pak mjaltë. Një kile, një gjysmë, një çerek!» Kërceva nga karrigia i xhindosur: «Mjaltë? Po unë ku ta gjej mjaltin, more djalë? 'A jeni në vete me këto kërkesa? Rraf e baf e te kryetari! Ku ta gjej mjaltin unë? Aaa, e mora vesh. Nga të kooperativës, ë? Jo, more xhan, jo! Pse të kujt i kam unë zgjojtë, të babait?» Ai kishte dalë me kohë nga zyra nga të bërtiturat e mia, kurse unë vazhdoja të turfulloja, ngaqë më vinte plasje se si këta njerëz nuk mendonin. Ja, kështu. Është e tepërt t'i bëj koment. Hëngra atje edhe tre vjet si llogaritar. Kur erdha në qytet, në një rast, ashtu si atij fshatarit më ndodhi edhe mua e m'u kujtua mjalti. Që atëhere s'e fus më në gojë. Jo që s'e fus në gojë por, sa herë e shikoj, më ngjethet mishtë. S'më lë të qetë ndërgjegja.

Unë kisha përllarë pjatën tjetër dhe ndërçgje-
gja mëgjithatë nuk po më sëmbonte gjëkundi.

Hyri vajza, që solli pjatat, me dy gota ujë. I
piva të dyja unë.

Kryetari me të qeshur i tha vajzës:

— Sa bëjnë të dyja pjatat e mjaltit?

Unë u skuqa dhe menjëherë futa dorën në xhep.
Kryetari qeshte me të madhe.

— Jo. Kjo ishte qerasja. Paguaj unë. Mjaltin
e kemi të mënësës.

... m'këmbi me sulmimin u bëj rëndësi të madhe...
... nga baba, kështu që...
... siç e dija...
... të qafërjepurës...
... të qafërjepurës...
... të qafërjepurës...
... të qafërjepurës...
VEZËT E QAFËRJEPURËS

Dy **pare** **pulë** ishte, me qafën të rjepur, me
kaçulitën në majë të kokës. S'të bëhej as t'i hidhje
sytë, por vezët ama, si bënte njerën, s'bënte tjet-
rën. Njerën me majë, tjetrën si top pingpongu; sot
pillte vezë me dy të verdha, nesër e bënte vezën
si dy kokrra të ngjitura bashkë në formë tete.

Të parët u bënë kureshtarë kalamajtë e shtë-
pisë. Sa kakariste ajo, ata suleshin ngado që të
ishin. Bërtisnin me të madhe:

— Bëri qafërjepura kokove! Bëri kaçulita ko-
koye!

Dhe suleshin drejt e në furrik!

— Piii! Si e paska bërë sot, urre!

— Ua... Si e flarinjtë duket!

Dhe nuk shkoi shumë e furriku i qafërjepu-
rës u bë vend që vizitohej nga kalamajtë e lagjes e
të fshatit. Madje nisi të vijë edhe ndonjë i rritur
për të parë vezët e çuditshme të qafërjepurës me
kaçulitë.

Ndonjëri nisi edhe studimet. Se kujt iu kuj-
tua t'i dërgonte në laborator t'u bëhej analiza lë-
vözhgave, së bardhës e së verdhës së vezëve. Njëri
nisi ta ndiqte këmba-këmbës dhe të përgjonte çfa-

rë hante ajo. Dikush tjetër u angazhua me kërkime historike e arkeologjike për gjenealogjinë nga e kishte prejardhjen qafërjepura. U gjet dhe një që mori përsipër studimin fiziologjik të aparatit vezë-krijues e vezëpjellës të kësaj pule ekstraspecie.

Pa nisi të ngrifej e të krekosej qafërjepura, se të gjithë ia krifnin bishtin. Suleshin kush e kush t'i lidhte në qafën e rjepur kordelet më të bukura e më të kushtueshme. Dhe qafërjepura me kuçulitë, me bishtin përperjetë tundej e shkundej, me sqepin mënjane e sytë të perënduar. S'begeniste t'u jepte të njohur as gjelave.

Një mëngjez, fëmijët e fshatit dhe studjuesit e qafërjepurës u zgjuan më herët se çdo ditë tjetër nga një kakarisje fenomenale. Kurrë ndonjëherë gjatë lavdisë së saj qafërjepura s'kishte dalë nga furriku me një kakarisje të tillë.

Kalamajtë e studjuesit vërshuan te furriku i qafërjepurës Po ç'të shihnin. Nuk po merrej vesh se çfarë u shikonin sytë. Ç'thoshte njëri nuk thoshte tjetri.

— Margaritar!

— Jo. Më tepër duket si zog i ngordhur!

— Si copë zorre, më duket mua...

— Ore, mos është këlysh gjarpëri, mbledhur kutullaç!

— Je në vetë! Shiko ngjyrat. E bardha e përzierë me jeshilen e pak bojë kafe e të kuqe, japin refleksin si të gurit të rrallë. Xhevahir me siguri!

Një fshatar iu afrua grumbullit. Dëgjoi fjalët e tha:

— Pse i bëni punët kot së koti lesh e li? Çdo gjë ka emrin e vet. Ju pse s'i thoni në emër asaj

që është? Kjo që ka bërë qafërjepura tani e ka emrin e vet qëkur u krijuan pulat në këtë botë. S'ka pulë që të mos bëjë një gjë të këtillë!

— S'është e vërtetë! Kjo mund të jetë një vezë suigeneris.

Ky grumbull njerëzish bëri kuriozë edhe disa fshatarë të tjerë, të cilët erdhën aty e, me të parë se ç'kishte, nisën të qeshnin me të madhe.

Njëri u hodhë e tha:

— Përderisa pula jonë qafërjepur s'ka bërë kurrë dy kokrra vezë njëlloj, pse mos ta pranojmë edhe këtë si një nga llojet e modës së fundit të vezëve të saj?

Tjetri ia priti:

— E si ta pranojmë për vezë, kur shihet qartë se ç'është?

— Pse jo!? Edhe në qoftë se është ashtu si do të thuash ti, duhet patur parasysh se është e qafërjepurës dhe qafërjepura jonë edhe atë s'e ka si të të gjitha pulave të tjera.

— Phë — u prish në fytyrë dikush.

— Ç'ke që bën phë? Ja, merre e fërgoje në gjalpë! Me siguri s'ke për të bërë më phë, por ke për të lëpirë gishtërinjtë.

Rreth furrikut të qafërjepurës u ndez sherri. Arritën deri këtu sa të thonë:

— Ta therim qafërjepurën, se na polli nishanin e sherrit!

— Je në vete, ore?! Fundi i fundit, e keqja e të këqiave, cila është? Pula sado bukë veç të hajë, po pulë mbetet.

— Ta nxjerrim në gjyq! — thërriti njëri.

— Po pse, more shpirt?

— Se na ka prishur furrikun.

— Ç'na fole edhe ti! Si u nxirrka pula në gjyq?
Ja, të të vëmë ty kryetar e t'ia bësh gjyqin asaj.
Ti pyet, ajo kakaris.

Llafe, muhabet, thirr e bot, fryj e shfryj dhe dielli kaptoi shtatë hostenë në qiell. Vetëm atëherë fshatarët që ishin mbledhur rreth furrikut i thirrën mendjes. Njëri tha:

— Ore, ju iku dita pa mbjellë e pa korrur!
Ç'bëni kështu!? Ju, kalamaj, hajt, shpërndahuni e bëni detyrat që ju kanë dhënë mësuesit!

MIKROBET E NUZIT

Derisa i dha fund leximit të atij çarçafi, në fytyrën e Nuzit kaluan të shtatë ngjyrat e ylberit. E shtata dhe e fundit qe e zeza.

— Pse, fletërrufe është kjo? Kjo është çomage!

Dhe sulmoi me të dyja duart ta shqiste nga tabela e kuqe.

— Mos! — i tha një shok nga pas. — S'ke të drejtë!

Nuzi, siç e kishte nga natyra kur gjendej para të tjerëve, lëngëzoi dhe ëmbëlsoi si shurup bakllavaje paraqitjen e tij e tha:

— Do ta marr në shtëpi, që ta studjoj, të reflektoj dhe të përgjigjem.

Tjetri tha:

— Fletërrufetë nuk hiqen. Kopjoje në blok!

— Vërtet, mirë thua. Ja, që s'më shkoi fare në mendje — tha Nuzi dhe nxori blokun e stilolapsin.

Pasi ranë të flinin e shoqja, djali dhe vajza, Nuzi hapi blokun dhe filloi të përgatiste përgjegjen:

«...Kritika juaj është më se e drejtë, por pa baza. Unë me dorë në zemër po shfletoj para jush fletët e ndërgjegjes sime llogar dhe ju do të bindeni se më keni rënë më qafë pa të drejtë.

FLETE BRUFE

.....

.....

.....

.....

.....


.....

.....

.....

.....

.....



Pikësëpári habitem se si nuk e vini re punën time si mësuës shembullor brenda dhe jashtë shkollës. Klasat ku jap mësim janë në lëndën time me përqindjen më të lartë të kalueshmërisë dhe këtë e vërtetojnë fare mirë: 1) kolonat e regjistrave që ndrisin në lëndën time me nota kaluese; 2) inspektori, i cili mbeti pa mend në orën e kontrollit që më bëri para tre muajve; 3) artikulli që shkroi në gazetë shoku im i fakultetit para një muaji e gjysmë. Kurse ju nuk i merrni fare parasysh këto dhe bazoheni te kontrollat shoqërore me të cilat më kenin rënë më qafë kaq shumë, sa çikë e nga një çikë erdhi e ju mbush mendja se nxënësit në lëndën time kanë përvetësuar vetëm çerekun e programit. Natyrisht, sa më thellë, më ruda i gjen. Mirë që s'ma nxitë faqen fare e ta merrte vesh gjithë dynjaja se nxënësit nuk kanë përvetësuar as gjysmën e çerekut të programit. Mua më shqetëson diçka më e madhe se kjo. Ku vajti, besimi juaj tek unë, kolegu dhe shoku juaj? Kur unë ju them zyrtarisht nëpërmjet regjistrave se nxënësit në lëndën time kalojnë 99 pikë 99 për qind, ju këtë nuk duhej ta kishit vënë në pikëpyetje, sepse del pikëpyetja tjetër: «Ku vajti personaliteti im?» Pesat e gjashtat nëpër regjistra unë i kam vënë të qarta e të bukura. Ju pse të mos u besoni syve, por u besoni kontrolleve dhe përvetësimit të lëndës nga nxënësit? Nxënësit, aq sa ia pret, aq përgjegjet. Po sikur ato pesa e gjashta t'i kisha shënuar katra, a do të kënaqeshit? Jam i sigurtë që jo. Do të kishit vënë kujën për përqindjen. Ju duhej të kishit reflektuar thellë para se të më qëndisnit atë çarçaf fletërrufeje, sepse me atë shkëlqim notash të lëndës

sime nuk nderohesha vetëm unë, por edhe ju, edhe shkolla. E ç'fituat ju tani që nxorët këto lakra në shesh?

Po për marrëdhëniet mësues-nxënës, ç'patët me mua? 'A gjeni dot një të dytë në shkollën tonë, që të ketë lidhur marrëdhënie më të mira me nxënësit, se sa unë? S'e besoj. Unë jam i vetmi mësues, që nxënësit më marrin nëpër... zemër, siç ua ka qejfi, bëjnë ç'të duan, fluturojnë kur ua ka ënda nga dritaret në orë të mësimit. A gjeni dot ndonjë nxënës çapkën që të ankohet për mua? S'e besoj. Përveç ndonjë merhumi, ndonjë të mbyturi, ndonjë miu librash, që i ka ikur moda me nemsen. Sepse unë për veten time kam menduar se freri gjithmonë nxjerr telashe, se pastaj duhet të presësh vicklat kurse, duke e lëshuar çdo gjë pa duar, s'u nxjerr belara as të tjerëve as vetes. E ç'na duhen belatë, kur mund të jemi rehat? S'di a më kuptoni.

Edhe aktivitetin tim shoqëror jashtë mureve të shkollës, ju si pa të keq ma përshkruani me ngjyra natyrale, sikur nuk keni lexuar kaq herë që natyralizmi ka qenë rrymë dekadente. Mirë nxënësve, se aq ua pret, por juve s'ju kishte hije të binit në këtë gabim. Kështu që unë kam mjaft argumenta t'ua hedh poshtë edhe këtë pikë të kritikës suaj të drejtë, por të pabazuar.

Kam bërë një llogari se sa orë, minuta e sekonda duhen që të punoj si mësues brenda e jashtë shkolle në punë shtetërore e shoqërore. Doli rumbullak dhjetë orë. Mirë nxënësve, që aq ua pret, por me ju habitem se si ju ka dalë nga mendja parimi i zbatimit të teorisë në praktikë! Ç'të keqe ka se teorinë që kërkon dhjetë orë punë shtetë-

rore në ditë, unë, me racionalizimin tim, kam arri-
tur ta ve në zbatim në pesë orë?! Habitem përsë-
ri se si këtë racionalizim ju e quani mosaktivizim
në problemet shoqërore. Ju e dini fare mirë që
sa i zënë jam me problemet e mia personale dhe
familjes sime. Si nuk e kuptoni se edhe unë bash-
kë me familjen time jemi një pjesë e shoqërisë
dhe pra del fare qartë se më ka rënë leshtë e ko-
kës për shoqërinë».

Me përgjegje në dorë e zuri gjumi. Kur u zgjua
ndjeu në rrëzë të veshit zërin e gruas: «Hajde bu-
rrë, hajde! Të bukur përgjegje që paske bërë! Kri-
mbur në mikrobe! U dashka që të të bëjë një di-
zinfektim të mirë kolektiv!»

-i në rradhë të parë të kësaj lloje të shprehjes së
-shprehjeve të tilla. Nëse kësaj lloje të shprehjes
ministrave të kësaj lloje të shprehjes së parë të
që kësaj lloje të shprehjes së parë të kësaj lloje të
shprehjes së parë të kësaj lloje të shprehjes së parë të
shprehjes së parë të kësaj lloje të shprehjes së parë të
shprehjes së parë të kësaj lloje të shprehjes së parë të

NA E NXOREN BOJEN GRATË

-edhe e shprehjes së parë të kësaj lloje të shprehjes së parë të
shprehjes së parë të kësaj lloje të shprehjes së parë të
shprehjes së parë të kësaj lloje të shprehjes së parë të
shprehjes së parë të kësaj lloje të shprehjes së parë të

-Na iemi tre shokë. Unë, Rakua e Lili.
-Përpara martesës shpesh bisedonim me njëri-
-tjetrin dhe ishim gjithmonë në një mendje.

Dhe e nisëm së mbari. Propozimet e shkesëve
i hodhëm poshtë me përbuzje. U dashuruam. Unë
me një brigadiere të bukur. Rakua me një skuadër-
komandante të lezeçme, Lili me një kooperativiste
topolake.

Dhe u fejuam. Mendimet tona nisëm t'i vinim
në jetë. U bëmë shembull për tërë fshatin. Të gji-
thë mësonin nga ne se ç'do të thotë emancipim.
Të fejuarat nuk i ndaluan të përshëndeteshin me
shokët e tyre, të vazhdonin të merrnin pjesë në
grupin e estradës së fshatit dhe të mbeteshin anë-
tare të organizatës së rinisë. E pse t'jua numëroj
kot të gjitha këto? Ju i dini vetë, se kaç herë janë
thënë e stërthënë, sa s'ka njeri të mos i ketë më-
suar përmendësh punët e emancipimit. E pra, ne
tre shokët e ngushtë i mbetëm besnikë emancipi-
mit edhe pasi u martuam. Nuk i mbyllëm nuset
tona brenda. Ajo e imja vetëm tri ditë qëndroi në
shtëpi dhe doli në punë. Nuk i rrihej, se si briga-
diere kishte merakun e brigadës. Ajo e Rakos e ajo

e Lilit rua bënë pak qejfin vjehrrave dhe ndenjën
nja pesë ditë e nusëruan. Já, kështu, ne të tre dhe
nuset tona ishim shembull emancipimi në fshat. Kof
që jua them të gjitha këto. Ju e dini vetë që grua
duhet çuar në kinema, në shëtitje, i duhet bërë
shok në punët brenda e jashtë shtëpisë e të tjera
e të tjera.

U martuam e u trashëguam. E para lindi topo-
lakja e Lilit. E dyta ajo e lezeçmja e Rakos. Dhe
e treta, bukuroshja ime. Të tria lindën çupa dhe
ne s'e prishëm gjakun, se s'i mbeti hatri asnjërit
e asnjërës. Veçse ndodhi një gjë që s'e prisnim.
Të tria nuset na u dobësuan pas lindjeve! Ta kam
fjalën, jo nga pamja, se ajo topolakja e Lilit për
shembull, po ashtu e shëndoshë e rrumbullake mbe-
ti. Por u iku fuqia. Dhe kur them u iku fuqia, u
iku me gjithë mend. Vinte ajo e imja nga fusha
telef. Shtëpia e priste rrëmuje, si shtëpi pa njeri.
Shkonte të merrte çupën në çerdhe, çupa me të sa-
jat. Fëmijë! E dini fare mirë se ç'do të thotë fëmi-
jë. Lëre! Lëre! S'dinim nga t'ia mbanim më parë
unë e ime shoqe.

Shkoja u qaja hallin shokëve të mi të ngushtë,
Rakos e Lilit, por ata ishin mbushur gjer në fyt
për vete.

— Shkurt, do njeri shtëpia, o vëlla — tha Ra-
kua.

— Shtëpia pa njeri s'është shtëpi — tha edhe
Lili.

U hodha unë:

— Unë po, kam hak të ankojem, por ju, o
vëllezër, keni pleqtë në shtëpi.

— Jo, o byrazer — thanë ata — ne jemi më

keq se ti, se pleqtë tanë, posa u bënë me nuse në shtëpi, katandisën më keq se fëmijët. Ti një çupë ke, kurse neve na llogarit nga tre kalamaj. Do njeri shtëpia. Edhe ato gra të shkreta u bënë telef, bam në arë e bam në shtëpi. Një shpirt kanë, de!

— Ashtu është — thashë unë.

Kërceu Rakua:

— Unë s'kam ç'bëj më. Do ta mbaj në shtëpi atë timen. Është e dobët për gjithë ato punë.

— Edhe unë — tha Lili. — U bë nënë, le të rritë fëmijën tani.

Fola dhe unë:

— Mirë e keni ju. Po emancipimit si t'ia bëjmë? Të mbyllim gratë në shtëpi, t'i heqim dome-thënë nga puna, dalim kundër emancipimit me flamur!

Të tre ranë në mendime të thella.

Pastaj i pari ia shkrepri Rakua:

— E gjeta — tha — e pse, me tapi e kemi marrë emancipimin ne? Ne tonën e bëmë. Le të bëjnë edhe të tjerët kaq sa ne.

— Ore s'e ke keq — u nxeh Lili. — Pse, gjer në vdekje u abonuam ne me emancipimin?

Mua më erdhi mirë. Nuk kisha menduar kurrë se mund të shpëtohej aq kollaj nga emancipimi.

Dhe të tre morëm vendim. I hoqëm nuset nga puna edhe fëmijët nga çerdhet. Nuk e patëm aq lehtë me to. Po më së fundi na kuptuan drejt. Ne i qanim hallin shëndetit të tyre. S'kishin përse të mos na besonin. Ne njiheshim për flamurtarë të emancipimit në fshat.

Edhe ta themi midis nesh, nuk kishte lezet



më të madh se sa kur ia hidhje emancipimit. Shpëtuam nga të gjitha! As punë shtëpie më, as kinema e më the e të thashë më... Ç'ta zgjas kot. E kthyem festen mbi sy. Aq sa, kur shtroheshim në ndonjë pijetore në qytet, gajaseshim të tre e talleshim: «A mendje, a mendje! Ç'na duhej neve emancipimi, o vëllezër!»

Mirëpo ato shejtankat, nuset tona, si duket, i ranë hilesë. Më kujtohet si sot. Mua, Rakon e Lilin bashkë me nja shtatë të tjerë na kishte çuar brigadieri të bënim silazh. Ama të dhjetë sa ishim, si diva ishim. Dhjetë kuinalë silazh në ditë bënim.

Kur na u çuan këto gratë tona nëpër shtëpi:

— Do të dal në punë — ngriti krye ajo bukuroshja ime.

— Dale moj — i thashë — ç'pate?

Dhe gërr fjalët unë e gërr lotët, duke i qarë hallin për shëndetin, se puna do fuqi, se shtëpia do njeri, se punoj unë për të... Pse, përmbahej ajo?

Ato ishin marrë vesh me njëra-tjetrën.

— Jemi dhjetë shoqe të mbyllura nëpër shtëpi, që kemi vendosur t'u tregojmë burrave se ne jemi më të ndërgjegjshme, më të ndershme, më të kujdesshme në punë. Dhe jua kalojmë juve. Sa kuinalë silazh bëni në ditë ju dhjetë burrat? Dhjetë? Turp të keni! Dhe njëqindherë turp të keni që na mbyllët si me marifet në shtëpi si në kohën e babaqemos! — më tha gruaja me zë të lartë.

Të nesërmen, me urdhër të brigadierit ne të dhjetët e silazhit u shpërndamë në punë të tjera e ua liruam vendin grave.

Tridhjetë e pesë kuinalë silazh bënë ato dhjetë dreqkat atë ditë.

Na e nxorën bojën.

SHKUNDJE

— E, di ç'ke ti, Nake, bjeri atij çekiçi dhe mbyll gojën! Hënde! Unë s'kam dëgjuar gjë.

— Aaa-ha-ha! Ç'më shkule gazit, o Zike... Po ti vetë kaq herë e ke vënë dhe e ke ngritur «Tuni kështu e Tuni ashtu»! Nga të paska hyrë tani ky lepur në bark?

— Kam thënë, ç'kam thënë, muhabete pa zarrar kanë qenë ato. Po jo kështu si doni të bëni ju. As që na takojnë neve këto punë. Ku s'ka pula, mos bëni ish!

— Na takojnë, si s'na takokan?

— Mua mos më ngatërroni! As ju mos u ngatërroni! Tjetri ka gurin e arrën në dorë, ju ngrifeni si gjelat e plehut! Bjeri atij çekiçi të them, mballos mirë ato këpucë! Plotëso normën! Dhe hë, tutje!

— O Zike! Po ti sikur s'ke qenë kështu, o derëzi! U plake kështu, apo si?

— Mos më shit të trasha ti mua! Deri aty ku më ha krahu e më arrin gjuha, ua fus të dyja këmbët në këtë këpucë që kam në dorë! Por në këtë mesele, që thua ti, s'kemi pse të fusim hundët, as unë as ju.

— Aman, o Zike, se më plase! Po ti vetë më

gojën tënde ke thënë: «Si s'e vënë përpara një herë këtë Tunin, por rrinë e ia krehin bishtin?» Ke thënë, apo s'ke thënë?

— E. Kam thënë. Edhe them. Për hyneret e tij. Po...

— Prit. Për hyneret e tij, për sjelljet «e bukur ra», për thesin me të meta dhe që ka bërë edhe dy-tre të tjerë me vete e janë bërë gurë kufiri e ngatërrojnë tërë drejtorinë që të mos pranohet Urania, vetëm pse s'ia pëlqeu të vëllanë për burrë.

— Ja, këtu e shkel ti tani. Ore çun, pse, unë e ti do t'i shkundim ata në drejtori? As unë as ti s'jemi në atë konak, ti dashke të hysh të hedhësh valle. Koka jote! Rri, ore, se ka të tjerë për atë punë. Kur të të thonë bujrrëm, atëhere ke të drejtë të merresh me punët e tyre.

— Zike, e ke gabim. Punët e tyre janë punët tona, punët tona janë të tyre. Kur nuk shkojnë mirë punët, kontrolli punëtor t'i mbledh të dyja këmbët në një këpucë.

— Ore, mos më bëj kaq fare mua! Pa më thuhaj: maqina drejton shoferin, apo shoferi drejton maqinën? Hënde! Oj, oj! U ngritkemi ne e i thënkërkemi drejtorisë «pa hajde, hapni dyert se do t'ju kontrollojmë!» O po mendje! Do t'u dalkemi ne përpara si këndezë pa pupla? Hënde!

— Hajde, or Zike, ç'të pret goja. Je i zoti, për nder. Veçse të ka ngatërruar pak burokracia!

— Si the, ore, si? Mua burokracia? Mendon apo i lëshon fjalët në erë? Ku e gjeta unë, o Nake, burokratllëkun? Te ky çekiçi që kam në dorë, apo te gjyryku i tim eti?

— Jo, jo. As atje, as atje. Por ke nevojë për sqarime.

— Nga koka jote? Pa hënde!

— Ata të drejtorisë nga kanë zbritur? Nga qielli? Jo. Ja, si djali yt, si im vëlla, njësoj janë. Kush e polli djalin tënd?

— Kush të të pëlcastin!

— E po e de! Djali yt, pse nuk do të pranoka ta kontrollosh ti? Ai s'ka frikë nga kontrolli yt, se kokën e tij ke ti...

— Ai ka kokën time, jo unë të tijën. Hënde, drejto gjuhën, se s'ka bërë vaki të pjellë veza pulën!

— E katranose fare tani, Zike, sepse se kush e ka bërë në fillim fare veza pulën apo pula vezën, nuk dihet ende. Po e kemi fjalën këtu: kokën e tët biri ke ti, kokën tënde ka yt bir, ç'i do zemra atij, të do zemra edhe ty. Është apo s'është kësh-tu? 'A e di kur do të kishte frikë yt bir nga kon-trolli yt? Kur t'i vinte kazmën zemrës tënde, zemrave tona, zemrës së popullit.

— Atë s'e bën ai, se ia këpus kokën!

— Hë, ta lumsha! Ja që erdhe me këmbët e tua. E shikon, si i thënke tët biri: «Hapu, se do të të kontrolloj»!

— Tjetër muhabet është ai. Ai është i'u bir, pastaj, ku di koka ime të kontrollojë ata, që dinë ku e ku më shumë!

— Të mësosh, o Zike!

— Eëë... edhe kësaj ia gjete. Një fjalë goje, «të mësosh».

— E po, kur t'i thuash vetes klasë punëtore, ta bësh hak. Sepse je në ballë dhe je në ballë jo

për t'u fryrë me erë si tollumbacja, as për t'u ngre-
hosur me pendët e palloit në ballë, as për të zhvatur
copën më të dhjamur.

— E ja, kështu bën ai Tuni ynë e s'ka burrë
t'i thotë: «dale beg, se ka hendek»!

— Të dalim ne pra e t'ia themi.

— Ja, këtu na ngatërron përsëri, ti, Nake. T'ia
thonë ata, ore, kur mbledhen, se unë e ti s'jemi në
mbledhjen e tyre. Nuk ditkan ata t'ia thonë e dit-
kemi ne?

— Ata janë pak, ne jemi shumë. Ca ti, ca unë,
ca tjetri e tjetri, ja që i ndihmojmë të na drejtojnë
edhe më mirë.

— Edhe këtu më lidhe. Po ata kanë edhe të
fshehtat e tyre, çështje të brendshme, si i thonë fja-
lës, që s'duhet të merren vesh.

— O Zike, po na ngatërron ti e jo unë. Ato
çështjet e brendshme pak janë e ne s'i duam ato.
Por të shumtat janë punët tona. Vret e pret si i do
qejfi Tunit, dhe kjo qenka çështje e brendshme? Jo,
o Zike, jo!

Në repartin e riparimeve hyri dikush nga të
drejtorisë. Vari një lajmërim. Njoftoi edhe me go-
jë, se pas një jave do të bëhej mbledhja e hapur
e organizatës së partisë me rend dite: «Grindjet
dhe familjariteti i sëmurë në administratë.

— E Zike, po tani, ç'thua?

— Sikur paskeni qenë me një mendje, o Nake,
ata brenda e ju jashtë. Mirëpo tani që do të hyjë
në gojën tonë, ai Tuni do të bëhet paçavure! E kush
do ta pyesë e kush do t'ia varë më atij?

— Kush tha se do ta bëjmë paçavure? Do ta
bëjmë t'i thërrasë mendjes e fiqirit e të marrë sa-

punin të lajë ndërgjegjen. Dhe kur ta lajë, do ta duam fort e më fort. Po ti, që mendon se i bie autoriteti, shiko se mos të ka ngecur në ndonjë cep ndonjë mbeturinë mikroborgjeze.

— Mbylle tani, të them! Më gjuajte qëparë me burokratllëkun, tani ma veshe me borgjezllëkun; e ku kërkon ta lësh vrapin?

— Mos u nxeh, Zike, luftë bëjmë. Po u vëmë fshesën të gjitha kalbësirave e mbeturinave që na ngatërrojnë punët e na dëmtojnë shëndetin.

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Muhamedi bredh me derra	3
Vëllezërit Zylalë	9
Dulja, Këçua dhe Likua në darë	13
Jastëku	18
Si e mbylli Kili Rrumbullaci	24
«Modernët»	29
Rrënjë	36
Kryetari nuk ha silazh	41
Letrat	47
«Pësimi» dhe mësimi	51
Një letër në fund të vitit	55
Fustani fluturues	59
Bëni një fletërrufe	65
Krimbi	70
Ëmbëlsimi	74
Vezët e qafërjepurës	79
Mikrobet e Nuzit	83
Na e nxorën bojën gratë	88
Shkundje	93

Tirazhi 4000 kopje Fjalori 70000000 1971-72

Shpërndarë nga: Shtëpia Botuese e Kulturës
 Shkollorë - Tiranë - 1971